



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
INSPEKTORATI SHTETËROR ARSIMOR

TREGUESIT PËR CILËSI NË PUNËN E SHKOLLAVE

- verzion punues -

Shkup, viti 2009

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Inspektorati Shtetëror Arsimor

Falemnderim

Falënderojmë kuadrot profesionale në shkollat edukativo-arsimore në Republikën e Maqedonisë, të cilët vunë në dispozicion njohuritë e tyre dhe dhanë kontribut të madh në hartimin e treguesve për cilësi në punën nëpër shkolla. Falënderojmë Zyrën për zhvillimin e arsimit, Prof. dr Violeta Petrovska Beshka, M-r Gorica Mickovska dhe z-nja Isobel McGregor, Inspektorati shtetëror i Skotlandës, për mendimin dhe përkrahjen e tyre profesionale gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti.

Grupi punues

Antoniela Stojanoska, Inspektore Shtetërore Arsimore
Vera Kondiq Mitkovska, Udhëhqëse e lartë e programeve, Mësimi Botëror
George Nikolov, Këshilltar i Ministrit për Arsim dhe Shkencë
Dime Atanasovski, Inspektor Shtetëror Arsimor
Jorda Jakovlevska, Inspektore Shtetërore Arsimore
Maja Petkovska, Koordinatore e lartë e programeve, Mësimi Botëror
Mitre Shuminoski, Inspektor Shtetëror arsimor
Xhelal Bexheti, Inspektor Shtetëror Arsimor
Shabedin Laçi, Inspektor Shtetëror Arsimor

Ky dokument është i përgatitur nga Inspektorati Shtetëror Arsimor, në bashkëpunim me Programin e USAID-it mbi zhvillimin e njeriut dhe të institucioneve dhe me përkrahjen e popullit amerikan, përmes Agjencisë së SHBA-ve për zhvillim ndërkombëtar (USAID).

Mendimet e shprehura në këtë dokument u përkasin autorëve dhe nuk shprehin qëndrimet e Agjencisë së SHBA-ve për zhvillim ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	4
PASQYRË E TREGUESVE TË CILËSISË DHE SUKSESIT NË PUNËN E SHKOLLAVE.....	6
Rajoni 1: Planet dhe programet mësimore	8
Rajoni 2: Arritjet e nxënësve	12
Rajoni 3: Mësimi dhe mësimdhënia	16
Rajoni 4. Përkrahja e nxënësve	24
Rajoni 5. Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë.....	30
Rajoni 6. Resurset	36
Rajoni 7. Udhëheqja, menaxhimi dhe krijimi i politikës	42
Përshkrimi i matësve.....	46

PARATHËNIE

Ministria e Arsimit dhe Shkencës gjithnjë kujdeset për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe të arriturave të nxënësve në Republikën e Maqedonisë. Një segment i rëndësishëm i diagnosticimit të gjendjes konkrete është posedimi i treguesve të standardizuar objektivë për matjen e nivelit të cilësisë. Për këtë qëllim, Inspektorati shtetëror i arsimit, në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë dhe të vendit, me mbështetjen e Programit të USAID-it për zhvillim njerëzor dhe institucional, përpiloi Treguesit e cilësisë së punës së shkollave. Qëllimi dhe dedikimi i këtyre treguesve është të mundësojnë një pasqyrë precize për punën e institucioneve arsimore dhe të japin rekomandime për përmirësimin e punës.

Ky dokument ka përpunuar dhe ka përshkruar në mënyrë adekuate treguesit për matjen e cilësisë të punës nëpër shkolla. Inspektorati shtetëror arsimor hartoi treguesit, duke marrë parasysh përvojën e mirë ekzistuese nëpër shkolla. Treguesit e matjes së kualitetit të punës së shkollave, do t'u ndihmojnë drejtorëve dhe mësimitdhënësve, me anë të evaluimit personal, kurse inspektorëve shtetërorë arsimorë përmes evaluimit integral, të vlerësojnë efektshmërinë e shkollave.

Këta tregues, përveç tjerash, vlejné për disa faktorë që ndikojné në veprimtarinë e shkollave, me qëllim që:

- të vlerësohet kualiteti i punës nëpër shkolla, në bazë të kriterëve paraprakisht të përcaktuar;
- të identifikohen sferat në të cilat është i nevojshëm përmirësimi plotësues;
- të aftësohen kuadrot udhëheqëse për marrjen e vendimeve të qëndrueshme, lidhur me ruajtjen e anëve të mira dhe tejkalimin e mangësive të punës nëpër shkolla.

Treguesit janë të klasifikuar në shtatë sfera kyç (të cilat përputhen me kornizën për evaluim personal dhe integral) dhe kanë të bëjnë me aspektet kryesore të punës nëpër shkolla:

1. Planet dhe progamët mësimore
2. Arritjet e nxënësve
3. Mësimi dhe mësimitdhënia
4. Përkrahja e nxënësve
5. Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë
6. Resurset
7. Udhëheqja, menaxhimi dhe krijimi i politikës

Secila sferë kyçe përmban numër të caktuar të treguesve për cilësi.

Për shembull, rajoni 3: **Mësimi dhe mësimitdhënia** përmban këta tregues për cilësi:

- 3.1 Planifikimi i mësimitdhënësve
- 3.2 Procesi i mësimitdhënies
- 3.3 Përvoja e nxënësve nga mësimi
- 3.4 Plotësimi i nevojave arsimore të nxënësve
- 3.5 Notimi si pjesë e mësimitdhënies
- 3.6 Raportim mbi progresin e nxënësve

Çdo tregues ka numër të caktuar të temave që kanë të bëjnë me ndonjë aktivitet të caktuar të shkollës.

Për shembull, treguesi 3.3 **Përvojat e nxënësve nga mësimi** i përmban temat në vijim:

- Mjedisi i mësimit
- Atmosfera e mësimit
- Inkurajimi i nxënësve për marrjen e përgjegjësisë
- Marrëdhënia nteraktive e nxënësve me të tjerët

Temat vlerësohen në katër nivele (*shumë mirë, mirë, mjaftueshëm dhe jo mjaftueshëm*). Dy nivele janë të përshkruara hollësisht (*shumë mirë* dhe *mjaftueshëm*) dhe përfshijnë ilustrime specifike, që kanë për qëllim të krijojnë kuptim reciprok mbi balansin midis anëve të mira dhe mangësive të shkollës.

- Me **shumë mirë** vlerësohen aspekte nga puna e shkollës ku mbizotërojnë anët e mira. Mund të ekzistojë një numër i vogël i mangësive, mirëpo ato nuk ndikojné shumë në përvojën e nxënësve në shkollë. Edhe pse *shumë mirë* është standardi më i lartë, këtë mund ta arrijné të gjitha shkollat. Ky standard vë në dukje se shkolla është në rregull dhe nuk duhet ndonjë angazhim

plotësues. Megjithatë, pritet që shkolla të vazhdojë të mbajë nivelin e lartë të këtij aspekti dhe t'i shfrytëzojë të gjitha mundësitë dhe përvojat e mira që i ofrohen për përmirësim të mëtejshëm.

- Me **mirë** vlerësohen aspekte të punës në shkollë, me një numër të madh të anëve të mira. Ekzistojnë edhe mangësi, mirëpo ato nuk kanë ndikim të rëndësishëm negativ, qoftë individualisht qoftë në grupe, mbi përvojën e nxënësve në shkollë. Vlerësimi *mirë* mund të jepet në rrethana të ndryshme. Për shembull, mësimi dhe mësimdhënia janë adekuate dhe si rezultat i kësaj, përvoja e nxënësve është pozitive, mirëpo mund të konkludohet se nxënësit nuk kanë sfida të mjaftueshme. Ky aspekt shpesh karakterizohet me anë të mira, por ka një ose disa mangësi që ndikojnë në kualitetin e përgjithshëm të përvojës së nxënësve.
- Me **mjaftueshëm** vlerësohen aspekte të punës së shkollës që kanë disa anë të mira, por kanë numër të konsiderueshëm të mangësive, të cilat ndikojnë në përvojën e nxënësve. Në tërësi, kur jepet vlerësimi *mjaftueshëm*, nënkuptohet se shkolla duhet të ndër marrë aktivitete strukturore dhe me kohë, për të përmirësuar gjendjen. Vlerësimi *mjaftueshëm* jepet në rrethana të ndryshme. Mund të ekzistojnë anë të mira, por gjithashtu edhe mangësi, të cilat veçmas ose në grupe, mund ta dëmtojnë kualitetin e punës në shkollë.
- Me **jo mjaftueshëm** vlerësohen aspektet e punës së shkollës, të cilat pasqyrojnë mangësi të mëdha, për të cilat shkolla duhet të ndër marrë aktivitete serioze plotësuese. Në këto raste, përvoja e nxënësve kërcënohet në disa aspekte kryesore. Në shumë raste, mësimdhënia vlerësohet me notën jo mjaftueshëm dhe nevojitet përkrahje plotësuese e udhëheqësisë, për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve përkatëse për përmirësim. Kjo mund të përfshijë nevojën për mbështetje nga kolegë me eksperiencë nga shkolla ose jashtë saj.

Ekzistojnë disa mënyra, me të cilat mund të grumbullohen provat lidhur me nivelet e cilësisë: përmes bisedave me të gjitha palët e interesuara, shqyrtimit të resurseve dhe dokumentacionit, mbikqyrjes direkte dhe analizës së dokumenteve. Në vazhdim të çdo treguesi, ekziston një pjesë me burimet e të dhënave, nga ku shkollat dhe inspektorët duhet të marrin informata relevante mbi çdo tregues.

Në përgjithësi, shpresojmë që ky dokument të kontribuojë në ndryshimin e mëtejshëm pozitiv në gjendjen e arsimit në Republikën e Maqedonisë. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, do të përkrahë edhe më tej Inspektoratin Shtetëror Arsimor në përsosjen dhe plotësimin gradual të këtyre treguesve, në bazë të përvojës së mirë që ekziston nëpër shkolla. Përdorimi i përgjithshëm i treguesve, do të mundësojë partneritet të vazhdueshëm në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, gjë që paraqet përfitim plotësues për të gjitha palët e involvuara në procesin arsimor.

Z. Nikola Todorov, Ministër
Ministria e arsimit dhe shkencës
së Republikës së Maqedonisë

PASQYRË E TREGUESVE PËR CILËSI NË PUNËN E SHKOLLAVE

Rajoni 1: Planet dhe programet mësimore		
Nr.	Treguesit e cilësisë	Temat
1.1	Realizimi i planeve dhe programeve arsimore	<ul style="list-style-type: none"> Planet dhe programet e aplikuara Informimi i prindërve dhe nxënësve mbi planet dhe programet mësimore Adaptimi i programeve mësimore për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore Zgjedhja e lëndëve mësimore Realizimi i programeve të zgjeruara
1.2	Cilësia e planeve dhe programeve arsimore	<ul style="list-style-type: none"> Barazia gjinore dhe etnike dhe sensibiliteti multikulturor në programet mësimore dhe mjetet ndihmëse mësimore Integrimi i karakteristikave dhe nevojave të mjedisit lokal në programet dhe mjetet ndihmëse mësimore Integrimi i qëllimeve të përgjithshme (ndërmjet lëndëve) të arsimit Ndikimi i mësimdhënësve dhe prindërve në planet dhe programet mësimore
1.3	Aktivitetet e lira	<ul style="list-style-type: none"> Vëllimi dhe llojllojshmëria e aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara jashtë mësimore Përfshirja e nxënësve në aktivitetet jashtë mësimore Inkuadrimi i nxënësve në zgjedhjen dhe planifikimin e punës gjatë aktiviteteve jashtë mësimore Afirmimi i nxënësve dhe shkollës përmes aktiviteteve jashtë mësimore
Rajoni 2: Arritjet e nxënësve		
Nr.	Treguesit e cilësisë	Temat
2.1	Arritjet e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> Ndjekja e arritjeve të nxënësve të gjinive të ndryshme, përkatësive të ndryshme etnike (dhe gjuha e mësimdhënies), sipas lëndëve dhe periudhave kualifikuese Përmirësimi i arritjeve të nxënësve të gjinive të ndryshme, përkatësive të ndryshme (dhe gjuha e mësimdhënies) Identifikimi i nxënësve me aftësi të vështirësuar të mësimin, i nxënësve të talentuar dhe nxënësve që kanë nevoja të veçanta mësimore Përmirësimi i arritjeve të nxënësve, me anë të mësimdhënies së rregullt dhe plotësuese Ndjekja e arritjeve të nxënësve gjatë kalimit nga një cikël në tjetrin dhe nga një nivel arsimor në një tjetër
2.2	Mbajtja/ shpërndarja e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> Përfshirja e nxënësve Rregullshmëria në mësim Shpërndarja e nxënësve Transferimi i nxënësve nga një shkollë në tjetrën
2.3	Përsëritja e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> Nxënës që nuk e mbarojnë vitin
Rajoni 3: Mësimi dhe mësimdhënia		
Nr.	Treguesit e cilësisë	Temat
3.1	Planifikimet e mësimdhënësve	<ul style="list-style-type: none"> Mbështetja dhe ndjekja e planifikimit të mësimdhënësve Planifikimet individuale të mësimdhënësve Këmbimi i përvojave dhe informatave gjatë planifikimit Orari
3.2	Procesi mësimor	<ul style="list-style-type: none"> Format dhe metodat arsimore Zgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve Marrëdhënia interaktive midis nxënësve dhe mësimdhënësve Qasja e arsimtarit ndaj nxënësve Ndjekja e procesit mësimor
3.3	Përvoja e nxënësve nga mësimi	<ul style="list-style-type: none"> Mjedisi për mësim Atmosfera për mësim Nxitja e nxënësve për të marrë përgjegjësi Marrëdhënia interaktive midis nxënësve dhe me të rriturit në shkollë
3.4	Kënaqja e nevojave të nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> Identifikimi i nevojave arsimore të nxënësve Respektimi i nevojave të ndryshme të nxënësve në procesin mësimor
3.5	Notimi si pjesë e mësimdhënies	<ul style="list-style-type: none"> Politika e shkollës për notim Metodat dhe format e notimit Përdorimi i informatave nga notimi në procesin mësimor
3.6	Raportimi i progresit të nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> Informimi i prindërve mbi progresin e nxënësve
Rajoni 4: Përkrahja e nxënësve		
Nr.	Treguesit e cilësisë	Temat
4.1	Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja nga lëndimet fizike dhe fatkeqësitë elementare Mbrojtja nga dhuna Mbrojtja nga konsumimi i duhanit, alkoolit dhe drogës Kualiteti i ushqimit që përdoret Përkrahja e nxënësve me pengesa fizike në zhvillim Kujdesi për nxënësit që rrjedhin nga familjet me gjendje të vështirë materiale
4.2	Shëndeti	<ul style="list-style-type: none"> Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet Kujdesi për nxënësit me probleme shëndetësore

4.3	Ndihma këshilldhënëse për arsimin e mëtejshëm të nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Ofrimi i ndihmës në përzgjedhjen e profesionit/institucionit për arsim të mëtejshëm, rikualifikim ose punësim • Kujdesi për nxënësit me vështirësi emocionale
4.4	Ndjekja e progresit	<ul style="list-style-type: none"> • Evidentimi i progresit individual të nxënësve • Analizimi i progresit të nxënësve nëpër klasa
Rajoni 5: Atmosfera në shkollë		
Nr.	Treguesit e cilësisë	Temat
5.1	Atmosfera dhe relacionet në shkollë	<ul style="list-style-type: none"> • Prestigji/imazhi i shkollës • Kodi i sjelljes • Atmosfera shkollore • Sjellja dhe disciplina në shkollë • Pjesëmarrja e nxënësve në zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve
5.2	Promovimi i arritjeve	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i arritjeve individuale të nxënësve • Promovimi i arritjeve në emër të shkollës
5.3	Barazia dhe drejtësia	<ul style="list-style-type: none"> • Njohja e të drejtave të fëmijëve • Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve • Pranimi dhe inkurajimi i multikulturalizmit
5.4	Raporti i partneritetit me prindërit dhe më komunitetin lokal dhe afarist	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimi i shkollës me prindërit • Bashkëpunimi me komunitetin lokal • Bashkëpunimi me komunitetin afarist dhe sektorin joqeveritar
Rajoni 6: Resurset		
Nr.	Treguesit e cilësisë	Temat
6.1	Akomodimi dhe kapacitetet hapsinore	<ul style="list-style-type: none"> • Kushtet e hapësirës • Shfrytëzimi i kapaciteteve hapsinore
6.2	Mjetet dhe materialet mësimore	<ul style="list-style-type: none"> • Pajisja me literaturë profesionale, me mjete dhe tekste mësimore • Biblioteka e shkollës • Materiali shpenzues
6.3	Sigurimi i kuadrove të nevojshme mësimore	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i të punësuarve dhe kuadri arsimor adekuat • Efektshmëria dhe vendosja e kuadrit • Shërbimi profesional si përkrahje e kuadrit arsimor
6.4	Ndjekja e nevojave për zhvillim të kuadrove mësimore	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi profesional i mësimdhënësve
6.5	Puna financiare në shkollë	<ul style="list-style-type: none"> • Masat me të cilat sigurohet respektimi i rregullativës ligjore për punë financiare • Transparenca në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit shkolllor
Rajoni 7: Udhëheqja, menaxhimi dhe krijimi i politikës		
Nr.	Treguesit e cilësisë	Temat
7.1	Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollës	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëheqja e shkollës • Menaxhimi i shkollës
7.2	Synimet dhe krijimi i politikës së shkollës	<ul style="list-style-type: none"> • Synimet e arta dhe adekuata • Procedurat e krijimit të politikës shkollore
7.3	Planifikimi zhvillimor	<ul style="list-style-type: none"> • Synimet e planifikimit zhvillimor • Zhvillimi profesional/ trajnimi profesional e kuadrove • Mjetet materiale dhe teknike • Infrastruktura

Rajoni 1: Planet dhe programet mësimore

Nr.	Treguesit për cilësi	Temat
1.1	Realizimi i planeve dhe programeve mësimore	<ul style="list-style-type: none">• Planet dhe programet e aplikuara mësimore• Informimi i prindërve dhe nxënësve mbi planet dhe programet mësimore• Adaptimi i programeve mësimore për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore• Zgjedhja e lëndëve mësimore• Realizimi i programeve të zgjeruara
1.2	Cilësia e planeve dhe programeve mësimore	<ul style="list-style-type: none">• Barazia gjinore dhe etnike dhe sensibiliteti multikulturor në programet mësimore dhe mjetet ndihmëse mësimore• Integrimi i karakteristikave dhe nevojave të mjedisit lokal në programet mësimore dhe mjetet ndihmëse mësimore• Integrimi i qëllimeve të përgjithshme (ndërmjet lëndëve) të arsimit• Ndikimi i mësimdhënësve dhe prindërve në planet dhe programet mësimore
1.3	Aktivitetet jashtë mësimore	<ul style="list-style-type: none">• Vëllimi dhe llojlojshmëria e aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara jashtë mësimore• Përfshirja e nxënësve në aktivitetet jashtë mësimore• Inkuadrimi i nxënësve në zgjedhjen dhe planifikimin e punës në aktivitetet jashtë shkollore• Afirmimi i nxënësve dhe i shkollës, përmes aktiviteteve jashtë mësimore

1.1 Realizimi i planeve dhe programeve mësimore

Temat:

- * Planet dhe programet e aplikuara mësimore
- * Informimi i prindërve dhe nxënësve për planet dhe programet mësimore
- * Përshtatja e programeve mësimore për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore
- * Zgjedhja e lëndëve mësimore
- * Realizimi i programeve të zgjeruara

Shumë mirë

- * Planet dhe programet e aplikuara mësimore janë në pajtim me dokumentet programore të Ministrisë për Arsim dhe Shkencë. Planet dhe programet mësimore realizohen në vëllimin e paracaktuar.
- * Shkolla ka prezantuar procedura dhe është duke përdorur disa medime (mënyra) të ndryshme për t'i informuar anëtarët e Këshillit të prindërve dhe prindërit tjerë, si dhe të gjithë të tjerët që kërkojnë informata, mbi qëllimet e planeve dhe programeve mësimore që janë duke u realizuar.
- * Përmes organeve zyrtare¹, shkolla planifikon aktivitete për grumbullimin dhe shqyrtimin e mendimeve të mësimitdhënësve dhe prindërve mbi planet dhe programet mësimore, dhe propozon iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e tyre në Ministrinë për Arsim dhe Shkencë, Entin për Zhvillimin Arsimor dhe/ose në Qendrën për arsimim dhe trajnim profesional.
- * Shkolla posedon kapacitete për adaptimin e programeve mësimore në të gjitha lëndët, sipas nevojës së fëmijëve me kërkesa të veçanta arsimore. Me fëmijët që kanë kërkesa të veçanta arsimore dhe që janë të inkuadruar në mësim të rregullt, punohet në bazë të programeve të adaptuara mësimore.
- * Ekzistojnë shembuj pozitivë të integritit adekuat të karakteristikave të mjedisit lokal në programet mësimore.
- * Shkolla ka hartuar drejtime për inkuadrimin e qëllimeve ndërmjet lëndëve² në të gjitha programet mësimore që do të realizohen. Mësimitdhënësit i respektojnë këto drejtime.
- * Shkolla ofron mbi (3) lëndë zgjedhore, sipas planit mësimor dhe specifikave të mjedisit lokal. Procedura e zgjedhjes së lëndëve mësimore zbatohet plotësisht, me respektimin konsekuent të nevojave dhe kërkesave të nxënësve.
- * Shkolla realizon programe të zgjeruara, duke respektuar mundësitë dhe nevojat e nxënësve.

Mjaftueshëm

- * Planet dhe programet e aplikuara mësimore, janë në pajtim me dokumentet programore të dërguara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Planet dhe programet mësimore realizohen në bazë të në vëllimin e paracaktuar .
- * Shkolla informon vetëm prindërit që janë anëtarë të Këshillit prindor mbi qëllimet e planeve dhe programeve mësimore që janë duke u realizuar.
- * Shkolla punon me fëmijë që kanë nevoja të veçanta arsimore, të inkuadruar në mësimin e rregullt me programe të adaptuara mësimore për disa lëndë.
- * Ekzistojnë shembuj për integrimin e karakteristikave të mjedisit lokal në disa programe mësimore.
- * Një numër i vogël i mësimitdhënësve marrin përgjegjësinë për realizimin e qëllimeve ndërmjet lëndëve.
- * Shkolla ka prezantuar procedurën e zgjedhjes së lëndëve, por ofron më pak se tre (3) lëndë nga të cilat mund të zgjedhin nxënësit. Procedura e zgjedhjes së lëndëve mësimore nuk aplikohet në mënyrë konsekuente.
- * Shkolla zbaton programe të zgjeruara, të cilat nuk i përfshijnë të gjithë nxënësit që kanë nevojë për ato.

Burimet e të dhënave

Plane dhe programe mësimore të dhëna nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Program vjetor për punën nëpër shkolla; Planifikime tematike të mësimitdhënësve; Akte normative të shkollës; Udhëzime profesionale dhe drejtime për operacionalizimin e planeve dhe programeve mësimore; Evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik; Anketa me mësimitdhënësit, prindët dhe nxënësit; Intervistat me drejtorë, bashkëpunëtorët profesionalë, prindërit dhe nxënësit; Proçesverbale të Këshillit shkollor, Këshilli prindor dhe organet profesionale të shkollës; Broshurat dhe veb faqja e shkollës; Programi për punën e bashkësisë së nxënësve; Proçesverbalet e kontrollave paraprake të inspektorëve³

¹ Këshilli i mësimitdhënësve, Këshilli i prindërve, Bordi i shkollës

² Qëllimet ndërmjet lëndëve: zhvillimi i vetëbesimit, iniciativës, përgjegjësisë, respektimit të dallimeve dhe të drejtave fundamentale të njeriut, rritja e vetëdijes së nxënësve për RM si shoqëri multikulturore

³ Përdoret si burim i të dhënave në të gjitha rajonet për të cilat ofron informata

1.2 Cilësia e planeve dhe programeve mësimore

Tema:

- * Barazia gjinore dhe etnike dhe sensibiliteti multikulturor në programet mësimore dhe mjetet ndihmëse
- * Integrimi i karakteristikave dhe nevojave të mjedisit lokal në programet mësimore dhe mjetet ndihmëse mësimore
- * Integrimi i qëllimeve të përgjithshme (ndërmjet lëndëve) të arsimit
- * Ndikimi i mësimdhënësve dhe prindërve në planet dhe programet mësimore

Shumë mirë

- * Shkolla, përmes organeve formale⁴ planifikon aktivitete për mbledhjen dhe shqyrtimin e mendimeve për planet dhe programet mësimore dhe për mjetet mësimore ndihmëse nga arsimtarët dhe prindërit nga aspekti i barabarësisë gjinore dhe etnike dhe sensibiliteti multikulturor.
- * Ekzistojnë modele të mira të integritit adekuat me karakteristika të mjedisit lokal, në programet mësimore dhe mjetet ndihmëse mësimore.
- * Shkolla ka drejtime të hartuara për inkorporimin e qëllimeve ndërmjet lëndëve⁵ në të gjitha programet mësimore që do të realizohen. Mësimdhënësit do t'i respektojnë këto drejtime.
- * Shkolla merr iniciativë për ndryshimin dhe plotësimin e planeve dhe programeve mësimore, duke iu drejtuar Ministrisë për Arsim dhe Shkencë, Entit për Zhvillimin e Arsimit dhe Qendrës për arsimim dhe trajnim profesional.

Mjaftueshëm

- * Shkolla grumbullon dhe shqyrton mendime për planet dhe programet mësimore dhe për mjetet ndihmëse mësimore, nga aspekti i barabarësisë gjinore dhe etnike si dhe sensibilitetit multikulturor, vetëm përmes iniciativave të mësimdhënësve, prindërve ose organeve profesionale.
- * Ekzistojnë modele për integrim të veçantive të mjedisit lokal, në një pjesë të vogël të programeve mësimore.
- * Një pjesë e vogël e mësimdhënësve ndërmerr përgjegjësi për realizimin e qëllimeve ndërmjet lëndëve.
- * Shkolla rrallë ndërmerr iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e planeve dhe programeve mësimore, duke iu drejtuar Ministrisë për Arsim dhe Shkencë, Entit për Zhvillim të Arsimit si dhe Qendrës për arsimim dhe trajnim profesional.

Burimet e të dhënave

Planet dhe programet mësimore të sjella nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Program vjetor për punën e shkollës; Planifikim tematik i mësimdhënësve; Akte normative të shkollës; Udhëzime dhe drejtime profesionale për operacionalizimin e planeve dhe programeve mësimore; Evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik; Anketa me mësimdhënës, prindër dhe nxënës; Intervista me drejtorin, bashkëpunëtorë profesionalë, me mësimdhënës, prindër dhe nxënës; Proçesverbale nga Këshilli arsimor, Këshilli i prindërve dhe organeve profesionale të shkollës; Broshura dhe faqja e internetit të shkollës; Program për punën e bashkësisë së nxënësve; Proçesverbale nga mbikqyrës të mëparshëm të inspektimit⁶

⁴ Këshilli arsimor, Këshilli i prindërve, Këshilli i shkollës

⁵ Qëllimet ndërmjet lëndëve: zhvillimi i vetëbesimit, iniciativat, përgjegjësia, respektimi i dallimeve dhe të drejtave themelore të njeriut dhe ngritja e ndërgjegjes së nxënësve për përkatësinë shtetërore të Republikës së Maqedonisë si shoqëri multikulturore

⁶ Shfrytëzohet si burim i të dhënave në të gjitha rajonet për të cilat ofron informata

1.3 Aktivitetet e lira

Tema:

- * Vëllimi dhe llojlojshmëria e aktiviteteve jashtë mësimore të planifikuara dhe të realizuara⁷
- * Përfshirja e nxënësve në aktivitete të lira
- * Përfshirja e nxënësve në zgjedhjen dhe planifikimin e punës në aktivitetet e lira
- * Afirmimi i nxënësve dhe i shkollës përmes aktiviteteve të lira

Shumë mirë

- * Shkolla planifikon dhe realizon aktivitete të ndryshme të lira që shprehin nevojat dhe interesimin e nxënësve dhe shërbejnë për mbështetjen e zhvillimit të tyre personal dhe social
- * Numri më i madh i nxënësve janë të përfshirë së paku në një aktivitet të lirë për mbështetje të zhvillimit të tyre personal dhe social, pa dallim nga gjinia, përkatësia etnike dhe sociale. Shkolla siguron kushte për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe të nxënësve që rrjedhin nga familje me status të ulët social dhe ekonomik në aktivitetet e lira.
- * Nxënësit përfshihen në aktivitetet e lira, sipas zgjedhjes së vet. Nxënësit luajnë rol të rëndësishëm në përgatitjen e programeve të punës në aktivitetet e lira.
- * Nxënësit, me ndihmën dhe mbështetjen e shkollës dhe mësimdhënësve, marrin pjesë në manifestime të ndryshme dhe përpiqen të arrijnë sukses të lartë nëpër gara nga fusha të ndryshme që organizohen në nivel lokal, shtetëror ose ndërkombëtar. Ekzistojnë dhe shfrytëzohen mjete (për shembull: gazeta e shkollës, radio e shkollës, këndi shkollor e ashtu me radhë) për afirmimin e aktiviteteve të lira dhe të fryteve nga ato.

Mjaftueshëm

- * Shkolla planifikon, por nuk i realizon tërësisht aktivitetet e lira të planifikuara që shërbejnë për zhvillimin personal dhe social të nxënësve. Këto aktivitete të lira janë të kufizuara në disa lloje dhe nuk shprehin mjaftueshëm nevojat dhe interesat e nxënësve.
- * Në aktivitetet e lira, përfshihen një numër i vogël i nxënësve me përkatësi gjinore, etnike dhe me prejardhje sociale të ndryshme. Nuk janë siguruar kushte për pjesëmarrjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në aktivitetet e lira. Rekomandimi i mësimdhënësit është vendimtar në zgjedhjen e aktivitetit të lirë, si dhe në planifikimin e përmbajtjes së punës.
- * Janë të rralla rastet kur nxënësit marrin pjesë nëpër manifestime dhe në gara jashtë shkollës. Shumë pak i kushtohet vëmendje afirmimit të aktiviteteve të lira në shkollë.

Burimet e të dhënave

Program vjetor për punë; Program për mësim plotësues dhe programe tjera për aktivitete të lira; Evidencë dhe dokumentacion pedagogjik; Diploma, mirënjohje, fletëlavdërimi nga pjesëmarrjet në manifestime dhe gara; intervista/anketa me mësimdhënës, prindër, nxënës dhe me shërbimin profesional për aktivitetet e lira; Proçesverbale nga grupe profesionale

⁷ Me aktivitetet e lira në këtë kontekst nënkuptohet aktiviteti për mbështetjen e zhvillimit personal dhe social të nxënësve, siç janë seksionet e ndryshme, ekskurzionet, shfaqjet, e ashtu me radhë.

Rajoni 2: Arritja e nxënësve

Nr.	Tregues i cilësisë	Temat
2.1	Arritjet e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Ndjekje dhe arritje të nxënësve të gjinive dhe përkatësisë etnike të ndryshme (dhe gjuhës mësimore), sipas lëndëve mësimore dhe sipas periudhave kualifikuese • Përmirësimi i arritjes së nxënësve nga përkatësi të ndryshme gjinore, etnike (dhe gjuhës mësimore) • Identifikimi i nxënësve që kanë vështirësi në mësim, nxënësve me talent të veçantë dhe atyre me nevoja të veçanta mësimore • Përmirësimi i arritjes së nxënësve përmes mësimi të rregullt dhe përmes mësimi plotësues • Ndjekja e arritjes së nxënësve gjatë kalimit prej një cikli në një cikël tjetër dhe prej një niveli në nivel tjetër arsimor
2.2	Mbajtja/shpërndarja e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja e nxënësve • Rregullshmëria në mësim • Shpërndarja e nxënësve • Kalimi i nxënësve prej një shkolle në një tjetër
2.3	Përsëritja e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënës që nuk e mbarojnë klasën

2.1 Arritjet e nxënësve

Temat:

- * Ndjekja e arritjeve të nxënësve me përkatësi të ndryshme gjinore, etnike (dhe gjuhës së mësim⁸) në lëndët mësimore dhe sipas periudhës kualifikuese
- * Përmirësimi i arritjes së nxënësve me përkatësi të ndryshme gjinore dhe etnike (dhe gjuhës së mësim)
- * Identifikimi i nxënësve që kanë vështirësi në mësim, të nxënësve me talent të veçantë dhe të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore
- * Përmirësimi i arritjes së nxënësve përmes mësim të rregullt dhe plotësues
- * Ndjekja e arritjes së nxënësve gjatë kalimit prej një cikli në një tjetër dhe prej një niveli në një nivel tjetër arsimor

Shumë mire

- * Shkolla disponon me të dhëna për arritjen e nxënësve sipas përkatësisë gjinore dhe etnike (dhe sipas gjuhës mësimore), në të gjitha lëndët mësimore dhe për të gjitha periudhat kualifikuese.
- * Shkolla krijon bindjen se arritjet e nxënësve mund të përmirësohen. Sipas pasqyrës në arritjet aktuale të nxënësve (të fituara përmes testeve interne dhe të jashtme), shkolla planifikon dhe ndërmerr aktivitete të ndryshme për përmirësimin e vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve të përkatësive të ndryshme gjinore dhe etnike (dhe sipas gjuhës mësimore).
- * Shkolla ka sistem për identifikim të nxënësve që kanë vështirësi në mësim, të nxënësve me talent të veçantë, si dhe të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe vazhdimisht ndjek përparimin e tyre.
- * Në procesin e rregullt mësimor, shumica e mësimdhënësve mbështesin nxënësit që kanë vështirësi në mësim, nxënësit me nevoja të veçanta mësimore si dhe nxënësit me talent të veçantë, duke zgjedhur aktivitete adekuata sipas nevojave dhe mundësive të tyre. Gjatë tërë vitit, shkolla realizon mësim plotësues nga të gjitha lëndët, për të cilat nxënësit kanë vështirësi dhe mësim plotësues për nxënësit të cilët tregojnë rezultate të mëdha në disa fusha.
- * Shkolla, në mënyrë të vazhdueshme ndjek arritjen e nxënësve gjatë kalimit prej një cikli në një cikël tjetër dhe pas mbarimit të shkollës filllore dhe të mesme. Në qoftë se paraqiten ndryshime në arritjet e tyre gjatë kalimit prej një cikli në një cikël tjetër, shkolla i analizon shkaqet për një dukuri të këtillë dhe ndërmerr aktivitete për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Mjaftueshëm

- * Shkolla disponon të dhëna jo komplete për arritjet e nxënësve sipas përkatësisë gjinore dhe etnike dhe (sipas gjuhës mësimore).
- * Në bazë të pasqyrës së arritjes aktuale të nxënësve, shkolla herë herë planifikon dhe ndërmerr aktivitete të ndryshme sipas përkatësisë gjinore dhe etnike (dhe sipas gjuhës mësimore).
- * Shkolla i identifikon nxënësit e talentuar, nxënësit që kanë vështirësi në mësim si dhe nxënësit me nevoja të veçanta mësimore dhe zhvillimin e tyre nuk e ndjek në mënyrë sistematike.
- * Një numër i vogël i mësimdhënësve në procesin e rregullt mësimor, mbështesin nxënësit që kanë vështirësi në mësim, nxënësit që kanë nevoja të veçanta mësimore, si dhe nxënësit e talentuar. Shkolla realizon mësim plotësues në fund të vitit shkollor për të gjithë nxënësit që kanë nota të dobta në disa lëndë. Mësim plotësues për nxënësit që tregojnë rezultate të veçanta në disa lëndë, organizohet herë herë dhe vetëm në një ose dy lëmi.
- * Shkolla i ndjek arritjet e nxënësve gjatë kalimit prej një cikli në një cikël tjetër dhe nuk ndërmerr aktivitete të veçanta për tejkalimin e ndryshimeve që paraqiten në këto situata.

Burimet e të dhënave

Programe dhe raporte shkollore; Evaluim personal; Proçesverbale nga organe profesionale të shkollës, Këshill shkollor, Këshilli i prindërve; Raporte nga shërbime profesionale; Rezultate nga vlerësimi intern dhe i jashtëm; Pasqyra krahasuese të rezultateve nga vlerësimet (ndërkombëtare, shtetërore, të qytetit, garat shkollore); Analiza të suksesit; Anketa/ intervista me mësimdhënës, prindër dhe nxënës; Mbiqyrja e orës mësimore nga ana e grupit inspektues; Dosje të nxënësve; Program për mësim plotësues;

⁸ Arritjet e nxënësve sipas gjuhës së mësimit ndiqen vetëm nëpër shkollat, ku mësimi zhvillohet në më shumë gjuhë

2.2 Mbajta/ shpërndarja e nxënësve

Temat:

- * Përfshirja⁹ nxënësve
- * Rregullshmëria në mësim
- * Shpërndarja e nxënësve
- * Transferimi i nxënësve prej një shkolle në një tjetër

Shumë mirë

- * Shkolla ka të dhëna për përfshirjen e nxënësve të rajonit, ka ndërtuar politikë për përfshirjen e të gjithë nxënësve dhe ndërmerr aktivitete të ndryshme (vizita nëpër familje, fushata, bashkëpunim me institucionet kompetente, me bashkësinë lokale...) që t'i përfshijë të gjithë nxënësit e rajonit të vet.
- * Shkolla ndjek sistematikisht rregullshmërinë e nxënësve (sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike dhe sociale), i analizon shkaqet për mungesën në mësim (me arsye pa arsye) dhe ndërmerr masa konkrete me kohë, për të siguruar rregullshmëri më të lartë. Shkolla bashkëpunon me prindërit dhe vetqeverisjen lokale që të shtojë rregullshmërinë e nxënësve në mësim. Numri mesatar i mungesave të paarsyeshme është më pak se 5 për një nxënës dhe rregullshmëria e nxënësve shënon një përmirësim në raport me vitet e tjera shkollore.
- * Shkolla e ndjek shpërndarjen e nxënësve, i analizon shkaqet dhe, në bashkëpunim me vetqeverisjen lokale dhe me prindërit ndërmerr aktivitete konkrete me kohë, që ta zvogëlojë shpërndarjen. Shpërndarje nuk ka deri sa të mbarojë shkolla fillore, kurse shpërndarja në shkollën e mesme është më pak se 1%.
- * Shkolla e respekton procedurën për kalimin e nxënësve nga një shkollë në një tjetër. Gjatë kalimit në shkollë tjetër i dërgon informatat e rëndësishme për zhvillimin arsimor të nxënësit, ndërsa gjatë pranimit të ndonjë nxënësi nga ndonjë shkollë tjetër i kërkon të njejtat informatat dhe i merr parasysh gjatë punës së mëtejshme arsimore me nxënësit.

Mjaftueshëm

- * Shkolla ka të dhëna për përfshirjen e nxënësve në rajon, por nuk ndërmerr aktivitete konkrete që t'i përfshijë të gjithë nxënësit.
- * Shkolla e ndjek shpërndarjen e nxënësve, por nuk analizon shkaqet dhe nuk ndërmerr aktivitete që ta zvogëlojë shpërndarjen. Deri në mbarim të shkollës fillore, shpërndarja është më pak se 1%, ndërsa në shkollë të mesme është 3–5%.
- * Shkolla grumbullon të dhëna për mungesat e nxënësve (numrin e mungesave të arsyeshme dhe të paarsyeshme) por aktivitetet që i ndërmerr për pakësimin e numrit të mungesave nuk mbështeten në analiza dhe nuk kontribuojnë për rritjen e rregullshmërisë. Numri mesatar i mungesave të paarsyeshme është prej 8 deri 12 për një nxënës dhe rregullshmëria nuk shënon përmirësim në krahasim me vitet e kaluara shkollore.
- * Shkolla e respekton procedurën për kalimin e nxënësve nga një shkollë në një tjetër.

Burimet e të dhënave

Program për punë të shkollës, Raporte të shkollës; Lista e fëmijëve nga rajoni, që do të përfshihen në shkollë prej klasës së parë, arsimit fillor (nga shërbimet kompetente dhe nga njësitë e vetqeverisjes lokale); Analiza të përfshirjes, shpërndarja dhe mungesa nga mësimi. Bisedë me drejtor, me shërbim profesional dhe me mësimdhënës; Qasje në evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik; Informimi i shkollës drejtuar organeve kompetente (Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Inspektorati Shtetëror Arsimor); Proçesverbale nga takimet me prindër dhe me vetqeverisjen lokale. Evidenca për nxënës që kanë shkuar nga shkolla dhe nxënës që kanë ardhur në shkollë.

⁹ Përfshirja ka të bëjë vetëm me arsimin fillor

2.3 Përsëritja e nxënësve

Tema:

- * Nxënës që e humbin vitin

Shumë mirë

- * Përqindja e nxënësve që e mbarojnë vitin është vazhdimisht në rritje. Në shkollë ekzistojnë procedura të hartuara për identifikimin dhe analizën e shkaqeve për përsëritjen e vitit shkollor dhe shkolla ndërmerr masa me kohë, për zvogëlimin e numrit të nxënësve që përsërisin klasën. Shkolla i njofton nxënësit dhe prindërit me politikën e përparimit, me aktivitetet që i ndërmerr dhe me të drejtën për ankesë në rast të përsëritjes së vitit shkollor.

Mjaftueshëm

- * Përqindja e nxënësve që përsërisin klasën, nuk shënon rënie. Në shkollë identifikohen dhe analizohen shkaqet për përsëritjen e vitit shkollor, por nuk ka të dhëna për masa të ndërmarra për përmirësimin e gjendjes. Shkolla i njofton nxënësit për të drejtën e ankesës gjatë përsëritjes së vitit shkollor.

Burimet e të dhënave

Akte interne shkollore; Analiza për suksesin e nxënësve gjatë tri viteve të kaluara; Qasje në dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike. Bisedë me nxënës, prindër dhe me shërbim profesional.

Rajoni 3: Mësimi dhe mësimdhënia

Nr.	Tregues për cilësi	Temat
3.1	Planifikimi i mësimdhënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Përkrahje dhe ndjekja e planifikimit të mësimdhënësve • Planifikime individuale të mësimdhënësve • Shkëmbim i përvojave dhe informatave gjatë planifikimit • Orari i mësimi
3.2	Procesi mësimor	<ul style="list-style-type: none"> • Forma dhe metoda mësimore • Zgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve • Marrëdhëniet interaktive midis mësimdhënësve dhe nxënësve • Qasja e mësimdhënësve ndaj nxënësve • Ndjekja e procesit mësimor
3.3	Përvojat e nxënësve nga mësimi	<ul style="list-style-type: none"> • Mjedisi i mësimi • Atmosfera e mësimi • Nxitja e nxënësve që të ndërmarrin përgjegjësi • Marrëdhëniet interaktive të nxënësve midis veti dhe me më të rriturit në shkollë
3.4	Mjaftueshmëria e nevojave të nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i nevojave arsimore të nxënësve • Respektimi i nevojave të ndryshme të nxënësve në mësim
3.5	Notimi si pjesë e mësimi	<ul style="list-style-type: none"> • Politika e shkollës për notim • Metoda dhe forma të notimit • Shfrytëzimi i informatave nga notimi në mësim
3.6	Informim për përparimin e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Informim i prindërve për përparimin e nxënësve

3.1 Planifikimet e mësimdhënësve

Temat:

- * Mbështetja dhe ndjekja e planifikimit të mësimdhënësve
- * Planifikime individuale të mësimdhënësve
- * Këmbimi i përvojave dhe informacioneve gjatë planifikimit
- * Orari i mësimt

Shumë mirë

- * Në shkollë ka qasje të përcaktuara për planifikim dhe procedura të veçanta për mbështetjen dhe ndjekjen e planifikimit të mësimt nga ana e drejtorit, ekziston shërbim profesional dhe/ose persona të caktuar nga organet profesionale. Së paku dy herë në një gjysmëvjetor ndiqen planifikimet e mësimdhënësve nga ana e drejtorit ose shërbimi profesional.
- * Të gjithë arsimtarët kanë plane vjetore dhe tematike dhe përgatitje ditore që përmbajnë të gjitha elementet e domosdoshme për organizimin dhe realizimin e suksesshëm të orës¹⁰. Planifikimet e mësimdhënësve përmbajnë drejtime të qarta se çka duhet të pritet të mësojnë nxënësit (cilat janë rezultatet e pritura të mësimt), si dhe kur. Qëllimet e mësimdhënies, rezultatet e pritura nga mësimi dhe mënyra e notimit janë të përcaktuara me planifikimin, kurse kuadri arsimor i shfrytëzon informacionet nga notimi që të mund të identifikojë nevojat e nxënësve dhe t'i planifikojë hapat e mëtejshëm të mësimt. Aktivitetet, duke i përfshirë edhe detyrat e shtëpisë, janë planifikuar në atë mënyrë që të shfrytëzohet në mënyrë efektive koha e nxënësve edhe e mësimdhënësve.
- * Mësimdhënësit planifikojnë, në suazat e grupeve profesionale dhe këmbajnë përvoja dhe ide për planifikimin me anë të zbatimit të Teknologjive të informimit dhe të komunikimit, bashkëpunim rajonal me shkolla të tjera, konsultime me ekspertë, shfrytëzimin e nevojave ndërkombëtare etj.
- * Orarin e mësimt e bën shërbimi profesional në bashkëpunim me nxënësit, duke respektuar interesin e fëmijëve.

Mjaftueshëm

- * Në shkollë nuk ka qasje të përcaktuara për planifikim dhe procedura të caktuara për mbështetjen dhe për ndjekjen e planifikimit. Vetëm një herë gjatë gjysmëvjetorit ndiqen planifikimet e mësimdhënësve nga ana e drejtorit ose nga shërbimi profesional.
- * Pjesa më e madhe e mësimdhënësve përgatisin plane vjetore dhe tematike dhe përgatitje ditore, por përgatitjet e tyre nuk përmbajnë elementet e domosdoshme për organizimin dhe realizimin e orës. Planifikimet e mësimdhënësve japin drejtime të përgjithshme ose jo complete për atë se çka duhet të mësojnë nxënësit. Qëllimet e mësimdhënies dhe mënyra e notimit nuk janë shumë të qarta (mungojnë rezultatet e pritura të mësimt), ndërsa kuadri arsimor nuk i shfrytëzon informacionet e notimit, në mënyrë që t'i identifikojë nevojat e nxënësve dhe t'i planifikojë hapat e mëtejshme në mësim. Aktivitetet, duke i përfshirë edhe detyrat e shtëpisë, nuk janë planifikuar asisoj që koha e nxënësve të shfrytëzohet në mënyrë efektive.
- * Mësimdhënësit këmbajnë përvoja dhe ide vetëm në suaza të grupit profesional.
- * Orarin e mësimt e bën shërbimi profesional, sipas mundësive hapsinore dhe kadrovike të shkollës.

Burimet e të dhënave

Planifikime vjetore, tematike dhe përgatitje ditore (Kontrolli i planifikimit vjetor me kohë, kontrolli i realizimit me kohë të planeve tematike); Procedurë interne e përcaktuar për ndjekjen e planifikimit të mësimdhënësve; Lista për evidencë/Instrumente për ndjekjen e planifikimit të mësimdhënësve; Biseda me drejtorin, me shërbimin profesional, me mësimdhënësit; Proçesverbale nga mbledhjet e grupeve profesionale; Fakte të tjera për korrespondencë; Instrument për ndjekjen dhe vlerësimin e planifikimit dhe përgatitjes së orës mësimore.

¹⁰ Qëllimet e orës, aktivitetet, resurset, kontrolli i arritjeve, konstatimi, evaluimi i orës së realizuar

3.2 Procesi mësimor

Temat:

- * Forma dhe metoda mësimore
- * Zgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve
- * Marrëdhënie interactive midis mësimdhënësve dhe nxënësve
- * Sjellja e mësimdhënësve ndaj nxënësve
- * Ndjekja e procesit mësimor

Shumë mirë

- * Shfrytëzohen metoda dhe forma të llojllojshme mësimore (duke përfshirë edhe përdorimin e Teknologjive të informimit dhe komunikimit në mësim), të cilat janë në harmoni me nevojat e nxënësve dhe me stilin e tyre të mësimi. Mësimdhënësit shfrytëzojnë metoda mirë të planifikuara dhe adekuate që të punojnë me nxënësit edhe individualisht, në grupe të vogla ose me tërë paralelen. Mësimdhënësit, në mënyrë të suksesshme i zhvillojnë shkathtësitë individuale për mësim të secilit nxënës, si dhe shkathtësitë për bashkëpunim.
- * Detyrat që punohen në shkollë ose në shtëpi janë planifikuar mirë dhe janë të lidhura me punën e nxënësve gjatë orëve. Zgjedhja e detyrave dhe aktiviteteve (me nivel të ndryshëm të ndërlikimit) i është përshtatur nevojave individuale arsimore të nxënësve, e cila gjithë ndihmon që nxënësit t'i arrijnë qëllimet e parashikuara të mësimi. Mësimdhënësit shfrytëzojnë resurse dhe qasje të ndryshme për mësim dhe mësimdhënie, duke mos u kufizuar vetëm në librat e miratuara shkollore dhe në literaturën plotësuese. Nxënësve u mundësohet të punojnë me ritmin individual.
- * Mësimdhënësit i ndajnë së bashku me nxënësit qëllimet e mësimi dhe rezultatet e pritura nga mësimi dhe ato i kuptojnë të gjithë nxënësit në të gjitha fazat e mësimi. Mësimi është adekuat me moshën dhe nivelin e arsimit të nxënësve. Shfrytëzohen metoda të ndryshme interaktive me nxënësit, që inkurajojnë dhe nxisin mësimin dhe ndërtimin e besimit midis mësimdhënësve dhe nxënësve. Nxënësit nxiten që në mënyrë aktive të marrin pjesë në mësim dhe kontributi i tyre vlerësohet. Mësimdhënësit shfrytëzojnë qasje pozitive, në mënyrë që t'i motivojnë nxënësit (përmes lëndave kur është e nevojshme). Mësimi në klasë është aktiv, dinamik dhe ka atmosferë pune.
- * Të gjithë mësimdhënësit me nxënësit sillen me respekt dhe me mirëkuptim, duke ndihmuar dhe duke bashkëpunuar. Gjatë kësaj ata nuk bëjnë dallim midis nxënësve nga aspekti gjinor, social dhe etnik ose përkatësia fetare. Mësimdhënësit nuk shfrytëzojnë stereotipe gjinore, etnike dhe fetare gjatë komunikimit me nxënësit dhe ndalojnë që edhe nxënësit të përdorin stereotipe të tilla.
- * Shkolla ka dispozita interne për ndjekjen e procesit mësimor dhe këto zbatohen rregullisht, ndërsa mësimdhënësin e vizitojnë në orë drejtori dhe shërbimi profesional, së paku dy herë në një gjysmëvjetor. Praktikohet që të këmbehen përvoja gjatë ndjekjes së punës së kolegëve nga ana e grupit profesional. Rezultatet e ndjekjes së punës shfrytëzohen pastaj për përmirësimin e procesit mësimor.

Mjaftueshëm

- * Metodën dhe format mësimore, (duke përfshirë këtu edhe përdorimin e Teknologjive të informimit dhe komunikimit në mësim) që i përdorin mësimdhënësit nuk përpudhen çdo herë me nevojat e nxënësve dhe nuk i përfshijnë të gjitha stilet e mësimi. Mësimdhënësit punojnë individualisht me nxënësit, në grupe ose me tërë klasën, por metodat që i shfrytëzojnë nuk janë çdo herë të zgjedhura në mënyrë adekuate. Mësimdhënësit sillen kryesisht një lloj me të gjithë nxënësit, gjë që nuk kontribuon për zhvillimin e shkathtësive individuale për mësim të secilit nxënës.
- * Një pjesë e detyrave të shtëpisë nuk janë të lidhura me punën e nxënësve gjatë orëve të mësimi. Zgjedhja e detyrave dhe aktiviteteve nuk është përthur mirë me nevojat individuale arsimore të nxënësve dhe jo gjithnjë nxënësit i arrijnë qëllimet e planifikuara mësimore. Mësimdhënësit shfrytëzojnë vetëm tekste të miratuara shkollore dhe doracakë.
- * Jo gjithnjë mësimdhënësit i njoftojnë nxënësit me qëllimin e mësimi. Mësimi shpesh herë është i pakuptueshëm për nxënësit dhe ka nevojë për përsëritje. Marrëdhënia interaktive me nxënësit vetëm rrallë nxit dhe formon besim midis mësimdhënësve dhe nxënësve. Nxënësit rastësisht nxiten që të jenë aktivë në mësim. Mësimdhënësit shumë pak i lavdërojnë nxënësit ose përdorin fraza të thjeshta.
- * Një pjesë e mirë e mësimdhënësve sillen me nxënësit me respekt reciprok, duke ndihmuar dhe duke bashkëpunuar dhe me mirëkuptim, pa bërë dallime midis nxënësve sipas përkatësisë gjinore, sociale, etnike dhe fetare. Shumica e mësimdhënësve nuk shfrytëzojnë stereotipe gjinore, etnike dhe fetare në komunikim me nxënësit, por nuk ndërmarrin asgjë në qoftë se nxënësit përdorin stereotipe të tilla.
- * Shkolla nuk ka dispozita interne për ndjekjen e procesit mësimor. Secilin mësimdhënës, drejtori dhe shërbimi profesional e viziton në orë vetëm një herë gjatë tërë vitit shkollor.

Burimet e të dhënave

Instrument për ndjekjen dhe vlerësimin e planifikimit të orës mësimore; Instrument për ndjekjen dhe vlerësimin e realizimit të orës mësimore; Instrument për ndjekjen dhe vlerësimin e zhvillimit të orës së mësimin; Instrument për ndjekjen dhe vlerësimin e krijimit të atmosferës në klasë; Instrument për ndjekjen dhe vlerësimin e punës së mësimit për notimin e nxënësve; Instrument për ndjekjen dhe vlerësimin e komunikimit të mësimit me nxënësit; Mbikqyrje në orë; Planifikime vjetore, tematike dhe ditore; Program i punës së drejtorit dhe shërbimit profesional; Anketa/Intervista me mësimit dhe me nxënës.

3.3 Përvojat e nxënësve nga mësimi

Temat:

- * Ambient për mësim
- * Atmosferë për mësim
- * Nxitja e nxënësve për marrjen e përgjegjësisë
- * Mënyrë interaktive e sjelljes së nxënësve midis veti dhe me më të moshuarit në shkollë

Shumë mirë

- * Nxënësit i përjetojnë klasat dhe hapësirat e tjera shkollore si mjet motivues dhe stimulues që nxit interesin e tyre për mësim. Punimet e nxënësve ekspozohen në vende të dukshme përkatëse (në shkollë dhe në klasë), duke respektuar norma estetike. Ato ndërrohen, në përputhje me qëllimet e mësimin dhe mësimdhënies. Çdo nxënës përfiton mundësinë që të ekspozojë ndonjë punim.
- * Nxënësit konsiderojnë se mënyra e mësimin në shkollë është interesante dhe ajo që mësohet është e lidhur me përditshmërinë. Gjatë orës së mësimin, pjesa më e madhe e mësimdhënësve i inkurajojnë nxënësit të mendojnë në mënyrë të pavarur, të shtrojnë pyetje dhe të nxjerrin përfundime për atë që mësojnë. Shumica e mësimdhënësve nuk i kritikojnë nxënësit para nxënësve të tjerë ose para të rriturve. Të gjithë nxënësit marrin pjesë aktive gjatë orës së mësimin.
- * Nxënësit konsiderojnë se ka mundësi ta shprehin mendimin e vet dhe që ai të merret parasysh në mënyrë serioze gjatë vendosjes dhe zgjedhjes së problemit. Nxënësit marrin mbi vete përgjegjësi të ndryshme në shkollë (gjatë mësimin dhe jashtë tij).
- * Nxënësit konsiderojnë se, shkolla nxit, motivon dhe realizon bashkëpunim midis nxënësve dhe të rriturve në shkollë, përmes formave të organizuara. Nxënësit punojnë bashkarisht në projekte të ndryshme, në mësim dhe jashtë tij me grupe me përbërje dhe madhësi të ndryshme.

Mjaftueshëm

- * Nxënësit konsiderojnë se në shkollë nuk ka klasa të mjaftueshme dhe hapësira të tjera që nxisin interes për mësim. Punimet e nxënësve ekspozohen por nuk i kushtohet kujdes dukshmërisë dhe vendit ku ekspozohen ato, nuk i kushtohet rëndësi qëllimit të ekspozimit as edhe estetikës.
- * Nxënësit konsiderojnë se vetëm disa herë mësimi është interesant dhe ajo që mësohet nuk është gjithnjë e lidhur me përditshmërinë. Një numër i vogël i mësimdhënësve i inkurajojnë nxënësit që të mendojnë në mënyrë të pavarur, të parashtrijonë pyetje dhe të nxjerrin përfundime nga ajo që mësojnë. Një pjesë e vogël e mësimdhënësve arrijnë të përmbahen që të mos i kritikojnë nxënësit para nxënësve të tjerë ose para të rriturve. Shumë pak nxënës janë aktiv gjatë orës së mësimin.
- * Nxënësit mendojnë se vetëm disa herë kanë mundësi ta shprehin mendimin e tyre dhe ai të merret parasysh. Nxënësit nuk janë përgatitur që të marrin përgjegjësi në mësim dhe jashtë tij.
- * Nxënësit mendojnë se bashkëpunimi midis nxënësve nuk është i mirë dhe se shumica e të rriturve në shkollë nuk janë të hapur për bashkëpunim me ta. Nxënësit punojnë në projekte grupore por në to mungon llojllojshmëria.

Burimet e të dhënave

Anketa me nxënës; Biseda me bashkësinë e klasës, me prindërit, me mësimdhënësit; Qasje në dosjet e nxënësve; Qasje në evidencën e shërbimit profesional; Program pune dhe raporte të bashkësisë së nxënësve.

3.4 Përbushja e nevojave të nxënësve

Temat:

- * Identifikimi i nevojave¹¹ arsimore të nxënësve
- * Respektimi i nevojave të ndryshme të nxënësve në mësim

Shumë mirë:

- * Kuadri mësimor dhe shërbimi profesional i identifikojnë në mënyrë sistematike nevojat arsimore të nxënësve, si edhe pengesat në procesin e mësimin të çdo nxënësi dhe ndërmarrin masa për realizimin e tyre, gjegjësisht për mënjanimin e tyre.
- * Shumica e mësimitdhënësve, gjatë procesit edukativ shfrytëzojnë teknika të ndryshme me çka u japin mundësi nxënësve, që me stile të ndryshme të mësimin të mësojnë sa më shumë që është e mundur. Gjatë notimit shfrytëzojnë teknika të ndryshme me çka i motivojnë nxënësit të mësojnë dhe të arrijnë maksimumin e tyre.

Mjaftueshëm

- * Kuadri arsimor dhe shërbimi profesional i identifikojnë nevojat dhe pengesat arsimore gjatë procesit të mësimin të secilit nxënës por nuk e bëjnë atë në mënyrë sistematike. Ndërmerren shumë pak aktivitete për plotësimin e nevojave ose për mënjanimin e pengesave.
- * Shumë pak mësimitdhënës shfrytëzojnë teknika të ndryshme për mësim dhe notim.

Burimet e të dhënave

Anketa për nxënës; Bisedë me bashkësinë e nxënësve, me prindërit, me mësimitdhënësit; Qasje në dosjet e nxënësve; Qasje në evidencën e shërbimit profesional; Program për punë dhe raporte të bashkësisë së nxënësve

¹¹ Nevojat arsimore të nxënësve përcaktohen individualisht (për secilin nxënës veçaveç) dhe me realizimin e potencialit maksimal për arritjen e nxënësit në shkollë.

3.5 Notimi si pjesë e mësimit

Temat:

- * Politika e shkollës për notim
- * Forma dhe metoda për notim
- * Shfrytëzimi i informatave nga notimi në mësim

Shumë mirë

Shkolla i zbaton dispozitat pozitive ligjore që e rregullojnë notimin e nxënësve. Shkolla ka politikë të definuar për notim, qëllimi themelor i së cilës është ta mbështesë mësimin e secilit nxënës, duke përfshirë edhe kodin e notimit. Shkolla ka kritere të harmonizuara për notim, me të cilat nxënësit dhe prindërit janë tërësisht të informuar.

- * Të gjithë mësimdhënësit shfrytëzojnë metoda dhe instrumente të ndryshme për notim dhe në mënyrë të vazhdueshme e ndjekin dhe notojnë zhvillimin e nxënësve. Nxënësit përfshihen në notim (përmes notimit personal, notimit midis veti, ndërtimit të kriterëve, mbajtjes së dosjeve). Qasja në notim ju mundëson nxënësve të arrijnë rezultate më të mira.
- * Të gjithë mësimdhënësit u japin informata kthyesë nxënësve për punën e tyre, diskutojnë me nxënësit për arritjet dhe përparimin e tyre. Theks i veçantë i vëhet vlerësimit të arritjeve aktuale të nxënësve dhe identifikimit të aktiviteteve të ardhshme që do të zbatohen në mësim. Mësimdhënësit i shfrytëzojnë tërësisht informatat e marra nga notimi që të përmirësojnë planifikimin dhe zbatimin e mësimit.

Mjaftueshëm

- * Shkolla i zbaton dispozitat pozitive ligjore që e rregullojnë notimin e nxënësve. Nxënësit dhe prindërit nuk janë të njoftuar me kriteret për notim.
- * Një pjesë e vogël e mësimdhënësve shfrytëzojnë metoda dhe instrumente të ndryshme për notim dhe në mënyrë të vazhdueshme e ndjekin dhe notojnë përparimin e nxënësve. Notimi shumë pak u ndihmon nxënësve që të përmirësojnë rezultatet.
- * Mësimdhënësit disa herë diskutojnë me nxënësit për arritjet dhe rezultatet e tyre dhe nuk u japin rregullisht informata kthyesë. Informata kthyesë shpesh nuk përmban detaje për arritjet dhe aktivitetet vijuese që duhet të ndërmerren. Mësimdhënësit shumë pak i shfrytëzojnë informatat e marra nga notimi, në mënyrë që t'i përmirësojnë planifikimet dhe zbatimin e tyre në mësim.

Burimet e të dhënave

Programi për punë i shkollës; Rregullore për notim dhe përparim të nxënësve; Rregullore interne për notim; Standarde për notim; Qasje në dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike; Mjete të shfrytëzuara për notim (teste të diturisë, lista për kontroll, lista me poena); Modele për punime të notuara të nxënësve; Proçesverbale të grupeve profesionale dhe këshillit arsimor, Anketa/Intervistë me nxënës dhe mësimdhënës. Anketa dhe intervista me prindër; Evidenca e mësimdhënësve për takime dhe mbledhje të realizuara prindore; Akte/kode interne të shkollës; Instrument për ndjekjen dhe vlerësimin e punës së mësimdhënësit për notimin e nxënësve.

3.6 Raporti për përparimin e nxënësve

Тема:

* Raporti i prindërve për përparimin e nxënësve

Shumë mirë

* Shkolla ka sistem të përcaktuar për informim të prindërve për përparimin e fëmijëve të tyre dhe e zbaton në mënyrë konsekuente. Sistemi i këtillë përfshin grumbullimin e rregullt të informatave për arritjen e nxënësve dhe dhënien e informatave konkrete transparente kthyesë prindërve dhe nxënësve për notat, duke përfshirë edhe rekomandime të hollësishme për përmirësimin e suksesit të secilit nxënës veçanërisht; Për këtë qëllim shfrytëzohen takime joformale dhe formale, takime individuale dhe grupore me prindërit, të cilat janë organizuar mirë dhe në të cilat jepen informata të qarta. Prindërit marrin edhe raporte me shkrim me informata dhe detaje për arritjen e fëmijës së tyre për çdo lëndë mësimore, duke përfshirë edhe informatat për zhvillimin personal dhe social të fëmijës. Nga prindërit kërkohet që të japin informata kthyesë pas raportit, pas të cilit ndërmerren aktivitete në përputhje me pikëpamjet e prindërve në raport me arritjen dhe përparimin e fëmijëve të tyre.

Mjaftueshëm

* Prindërit janë të informuar së në ç'mënyrë të komunikojnë me shkollën lidhur me arritjen e fëmijëve të tyre, por nuk janë të nxitur që ta bëjnë atë. Mësimdhënësit nuk grumbullojnë informata të rregullta për arritjen e nxënësve dhe nuk u japin informata kthyesë prindërve dhe nxënësve për notat e tyre. Ekzistojnë mundësi që prindërit të takohen me mësimdhënësit por këto takime nuk janë të shpeshta dhe informatat nuk janë konkrete dhe nuk e udhëzojnë prindin si ta ndihmojë fëmijën. Mësimdhënësit përgatisin raporte të shkruara vetëm për ata prindër fëmijët e të cilëve janë me sukses të dobët ose për prindërit fëmijët e të cilëve janë nxënës problematikë. Prindërve nuk u kërkohet që të japin informata kthyesë pas raportit.

Burimet e të dhënave

Qasje në dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike; Anketa dhe intervista me prindërit; Evidenca e mësimdhënësve për takimet dhe mbledhjet e realizuara prindore; Akte dhe kode interne të shkollës; Instrument për ndjekjen dhe vlerësimin e punës së mësimdhënësit për notimin e përparimit të nxënësit.

Rajoni 4. Mbështetja e nxënësve

Nr.	Tregues për cilësi	Temat
4.1	Kujdesi i gjithëmbarshtëm i nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtje nga lëndime fizike dhe fatkeqësi elementare • Preventivë ndaj dhunës • Mbrojtje nga konsumimi i duhanit, alkoolit dhe drogës • Cilësia e ushqimit që përdoret • Mbështetja e nxënësve me të meta fizike • Kujdesi për nxënësit që rrjedhin nga familje me gjendje të vështirë sociale
4.2	Shëndeti	<ul style="list-style-type: none"> • Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet • Kujdes për nxënësit me probleme shëndetësore
4.3	Ndihma këshilldhënëse për arsimin e mëtejshëm të nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Dhënia e ndihmës për zgjedhjen e profesionit /institucionit për arsim të mëtejshëm, rikualifikim ose punësim • Kujdes për nxënësit me vështirësi emocionale
4.4	Ndjekja e zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> • Mbajtja e evidencës për përparimin individual të nxënësve • Analiza e përparimit të nxënësve sipas paraleleve

4.1 Kujdesi i përgjithshëm i nxënësve

Temat:

- * Mbrojtje nga lëndime fizike dhe fatkeqësi elementare
- * Preventivë nga dhuna
- * Mbrojtje nga konsumimi i duhanit, alkoolit dhe drogës
- * Cilësia e ushqimit që përdoret
- * Mbështetja e nxënësve me të meta fizike në zhvillim
- * Kujdes për fëmijët që rrjedhin nga familje me gjendje të vështirë sociale

Shumë mirë

- * Hapësira shkollore është e sigurtë për zhvillimin e mësimin. Shkolla ka rregullore të përcaktuara dhe aktivitete për sigurimin e nxënësve gjatë mësimin në ndërtesën shkollore dhe në oborrin shkollor dhe këto i realizon sipas planifikimit. Nxënësit shfrytëzojnë pajime mbrojtëse gjatë realizimit të përmbajtjeve mësimore për arritjen e shkathtësive praktike. Infrastruktura në shkollë (mobiljet, shkallët, dyshemetë, çatitë, dritaret, prizat elektrike, oborri e ashtu me radhë) janë të sigurta dhe nuk paraqesin rrezik potencial për lëndimin e nxënësve. Të gjithë vendet potenciale të rrezikshme në shkollë, që nuk mund të shmangen (pusetat, prizat elektrike, shkallët, hapësirat e rrëshqitshme, etj) janë të shenjura në mënyrë të veçantë dhe nxënësit janë të vetëdijshëm për ekzistimin e tyre dhe dijnë se si të sillen me ato. Shkolla ka kuadër të trajnuar për dhënien e ndihmës së parë, në raste fatkeqësie të nxënësve në shkollë dhe i trajnon të gjithë mësimdhënësit që të dijnë të gjenden në këto situata. Shkolla ka akte interne për veprim në raste të fatkeqësive elementare dhe së paku një herë në vit simulon gjendje të tilla.
- * Shkolla posedon një dokument të shkruar në të cilin janë të definuara të gjitha format e sjelljes së nxënësve dhe të rriturve, të cilat llogariten dhunë fizike dhe psikike, me theks të veçantë të formave të shqetësimit seksual të nxënësve (midis veti dhe nga ana e të rriturve). Në shkollë ndalohet çfarëdo lloj forme e dhunës e manifestuar nga ana e të rriturve dhe nxënësve dhe përcaktohen mekanizmat për ballafaqimin eventual të dukurive të dhunës me forma të ndryshme. Dokumentin mund ta lexojë çdo kush (mësimdhënësit, nxënësit, prindërit). Të punësuarit e dinë rolin dhe përgjegjësinë e vet në procesin e mbrojtjes së fëmijës, ndërsa nevojave dhe brengave të fëmijëve iu qasen me kujdes duke u kujdesur për të drejtat, privatësinë dhe dinjitetin e tyre. Aktivitetet për mbrojtje dhe sigurim të nxënësve koordinohen me institucionet e bashkësisë lokale. Viktimat, prindërit e viktimave ose dëshmitarët e dhunës janë të njoftuar me të drejtat dhe procedurat dhënien e ankesave dhe në raste të tilla, shkolla vepron me kohë dhe pa anime.
- * Shkolla ka politikën e ndalimit të konsumimit të duhanit, alkoolit dhe distribuimit dhe konsumimit të substancave narkotike, gjë që nënkupton se në shkollë (nëpër klasa, nëpër zyra, tualete, në oborrin shkollor) nuk pihet duhan, nuk vihet në gjendje të dehur dhe nuk konsumohet alkool, si dhe nuk distribuohet dhe nuk shfrytëzohen substanca narkotike. Në bashkëpunim me bashkësinë lokale dhe me komunën, shkolla gjen mënyrë që ta pengojë përdorimin e alkoolit dhe substancave narkotike në oborrin e vet. Shkolla ka dispozita të shkruara për regjistrimin e dukurive të këtylla dhe ndërmer masa kur ato nuk respektohen.
- * Shkolla kujdeset për cilësinë e ushqimit që ua ofron nxënësve. Së paku dy herë një gjysmëvjetor i dërgon mostrat e ushqimit për hulumtim, në institucionin që është kompetent për të përcaktuar cilësinë e ushqimit. Në bashkëpunim me bashkësinë lokale dhe me komunën, shkolla zhvillon procedura me të cilat sigurohet kontrolli i cilësisë së ushqimit që u ofrohet nxënësve nëpër dyqanet e ushqimit në afërsi të shkollës. Në shkollë zhvillohet fushatë për ushqim të shëndetshëm midis nxënësve.
- * Shkolla ka dispozita të shkruara për kujdesin e nxënësve me të meta fizike në zhvillim. Shkolla bashkëpunon me prindërit dhe institucione të tjera relevante (për shembull, organizata joqeveritare) për sigurimin e kujdesit të fëmijëve me të meta fizike në zhvillim dhe posedon mekanizma moderne për ndihmën e bashkënxënësve që të japin ndihmë dhe të kujdesen për ata fëmijë. Qasja e shkollës është përshtatur me nevojat e nxënësve me të meta fizike në zhvillim. Nëpër hapësirat e korridoreve dhe nëpër klasa mundësohet lëvizja e tyre, ndërkaq ekziston edhe tualet i veçantë i përshtatur për nevojat e tyre.
- * Shkolla ka dispozita të shkruara për sigurimin e mjeteve materiale për nxënësit të cilët, për shkak të familjeve të tyre me gjendje të vështirë materiale, nuk kanë mundësi ta ndjekin mësimin me të njëjtat kushte si edhe nxënësit e tjerë (për shembull, për shkak të mospasjes së librave shkollorë dhe mjeteve mësimore) dhe të marrin pjesë në aktivitetet e lira të cilat kërkojnë mjete plotësuese (për shembull, ekskurzione, shfaqje dhe gara). Dispozitat zbatohen në praktikë për të gjithë nxënësit që rrjedhin nga familje me të ardhura të ulta materiale. Me këtë rast, shkolla bashkëpunon me prindërit, bashkësinë lokale dhe me institucione të tjera relevante (për shembull, qendra për punë sociale, organizata humanitare dhe bashkësi afariste).

Mjaftueshëm

- * Hapësira shkollore është e sigurtë për zhvillimin e mësimit. Shkolla posedon dispozita dhe aktivitete për sigurimin e nxënësve gjatë mësimit në mesin dhe oborrin e shkollës, por këto nuk realizohen sipas planit të parashikuar. Nxënësit jo gjithmonë shfrytëzojnë pajime mbrojtëse gjatë realizimit të përmbajtjeve mësimore, për arritjen e shkathtësive praktike. Infrastruktura e shkollës (mobiljet, shkallët, dyshemetë, çatia, dritaret, prizat elektrike, oborri, etj) janë të siguruar dhe nuk paraqesin rrezik potencial për lëndime të nxënësve. Në shkollë ekzistojnë të punësuar me shkathtësi për dhënien e ndihmës së parë nxënësve, gjatë lëndimeve në shkollë, por ka nevojë për trajnim plotësues. Shkolla posedon akt intern për veprimin në raste të fatkeqësive elementare, por nuk organizon simulime.
- * Shkolla ka dispozita ku definohej të gjitha format e sjelljes së fëmijëve dhe të rriturve, e cila konsiderohet dhunë psikike dhe fizike. Në shkollë ndalohej çfarëdo lloj forme e dhunës që manifestohet nga ana e të rriturve dhe nxënësve dhe theksohej mekanizma për ballafaqimin e shfaqjes eventuale të formave të ndryshme të dhunës. Të punësuarit kanë mirëkuptim për procesin e mbrojtjes së fëmijës, por ka nevojë për trajnimin plotësues të tyre. Ata u qasen nevojave të fëmijëve me kujdes, por jo gjithnjë i marrin parasysh të drejtat, privatësinë dhe dinjitetin e tyre. Viktimat, prindërit e viktimave dhe/ose dëshmitarët e dhunës, nuk e dinë procedurën e parashtrimit të ankesave dhe/ose janë skeptik se në qoftë se ankohen shkolla do të marrë masa me kohë dhe të paanshme.
- * Shkolla ka politikën për ndalimin e konsumimit të duhanit, alkoolit dhe distribuimit dhe konsumimit të substancave narkotike, që nënkupton se në shkollë konsumohet duhan vetëm në hapësira të caktuara, nuk vihet në shkollë në gjendje të dehur dhe nuk konsumohet alkool, si dhe nuk distribuohet dhe nuk shfrytëzohet substanca narkotike. Shkolla nuk mundet me sukses të ballafaqohet me këto dukuri në oborrin shkollor pas mbarimit të mësimit.
- * Shkolla kujdeset për cilësinë e ushqimit që u ofron nxënësve, por nuk ka procedura për kontrollimin e cilësisë së tij. Shkolla nuk siguron kontroll të cilësisë së ushqimit që u ofrohet nxënësve nëpër dyqanet në afërsi të shkollës.
- * Shkolla posedon dispozita të shkruara për kujdesin e nxënësve me të meta fizike në zhvillim dhe bashkëpunon me prindërit për sigurimin e kujdesit. Shkolla nuk ka mekanizma për t'i inkuadruar bashkënxënësit që t'u japin ndihmë dhe të kujdesen për fëmijët me të meta fizike në zhvillim. Qasja e shkollës nuk është e përshtatur për nevojat e nxënësve me të meta fizike në zhvillim dhe hapësira e korridoreve dhe klasave nuk mundësojnë lëvizjen e tyre të pavarur. Në shkollë nuk ekziston tualet i veçantë që është i përshtatshëm për nevojat e tyre.
- * Shkolla ka dispozita të shkruara për sigurimin e mjeteve materiale të cilat për shkak të gjendjes së vështirë materiale të familjes nuk janë në gjendje ta ndjekin mësimin si të gjithë nxënësit e tjerë dhe të marrin pjesë në aktivitete të lira, të cilat kërkojnë mjete plotësuese. Procedurat zbatohen në praktikë, në qoftë se sigurohet mbështetje financiare e jashtme dhe atë më shpesh për nxënësit me gjendje shumë të vështirë materiale.

Burimet e të dhënave:

Program pune i drejtorit; Program pune i shërbimit profesional; Proçesverbale (lista të evidencës) nga bisedat individuale me nxënës dhe me prindër; Qasje në evidencën pedagogjike (hartime projektesh), qasje në kapacitetet hapsinore dhe inspektim në orë; Udhëzime të shkollës për format dhe metodat që shfrytëzohen; Të dhëna për ushqim të organizuar të nxënësve; Intervista me mësime të ndryshme, prindër dhe nxënës; Të dhëna për tribuna dhe ligjëratat të organizuara në shkollë; Evidenca dhe informimi i shkollës për nxënës me probleme emocionale, fizike dhe sociale; Dosje të nxënësit; Program vjetor për punën e shkollës

4.2 Shëndeti

Temat:

- * Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet
- * Kujdesi për nxënësit me probleme shëndetësore

Shumë mirë

- * Higjiena e shkollës është në nivel të lartë. Tualetet e mësimdhënësve dhe të nxënësve janë të pastra dhe të dezinfektuara në çdo kohë të ditës. Shkolla kujdeset që nxënësit t'i shfrytëzojnë tualetet në mënyrë të rregullt dhe ta mbajnë higjienën personale. Korridoret dhe shkallët pastrohen më së paku tre herë në ditë, dyshemeja dhe mobiljet në shkollë pastrohen më së paku para fillimit të çdo ndërrimi, hapësira tjetër shkollore së paku një herë gjatë ditës, kurse dritaret, dyert dhe inventari tjetër së paku nga dy herë në çdo gjysmëvjetor. Oborri i shkollës është i pastër, nuk ka mbeturina dhe ka gjelbërim që mirëmbahet. Në oborrin e shkollës, në çdo klasë dhe nëpër korridore ka shporta për mbeturina dhe shkolla kujdeset që nxënësit t'i hedhin mbeturinat në to. Shkolla ka program për preventivë kundër sëmundjeve ngjitëse.
- * Shkolla ka dispozita të shkruara¹² për kujdesin e nxënësve që për shkak të sëmundjeve kronike ose lëndimeve më serioze mungojnë më gjatë nga mësimi i rregullt. Procedurat zbatohen në praktikë për të gjithë nxënësit që kanë nevojë për një trajtim të tillë. Me këtë rast, shkolla bashkëpunon me prindërit, me bashkësinë lokale dhe me institucione të tjera relevante (për shembull, klinika, ambullanta, qendra për punë sociale).

Mjaftueshëm

- * Tualetet e mësimdhënësve dhe të nxënësve janë të pastra në çdo kohë të ditës. Korridoret shkallët, dyshemeja e shkollës dhe hapësirat tjera shkollore pastrohen më së paku një herë në ditë, mobiljet një herë në javë, ndërsa dritaret, dyert dhe inventari tjetër nga një herë në çdo gjysmëvjetor. Oborri i shkollës nuk ka mbeturina. Në shkollë ka shporta për mbeturina. Në rast të shfaqjes të ndonjë sëmundjeje ngjitëse, shkolla ndërmer procedurën për mbrojtjen nga përhapja e saj.
- * Shkolla ka dispozita të shkruara për kujdesin e nxënësve që për shkak të sëmundjeve kronike ose lëndimeve më serioze mungojnë më gjatë nga mësimi i rregullt. Procedurat zbatohen në praktikë me iniciativën e kujdestarit të klasës ose mësimdhënësit lëndor, në bashkëpunim me prindërit dhe/ose institucione të tjera relevante (për shembull, ambullanta dhe qendra për punë sociale).

Burimet e të dhënave:

Program vjetor i punës së shkollës; Rendi shtëpiak; Rregullore për organizimin dhe sistematizimin e punës dhe vendeve të punës; Proçesverbale të organeve të shkollës; Proçesverbale të organeve kompetente për kontrollin e higjienës dhe shëndetit të fëmijëve; Qasje në dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike; Qasje në hapsirën shkollore.

¹² Dokument i cili në vete përmban hapat, personat përgjegjës dhe resurset e nevojshme për realizimin e ndonjë aktiviteti dhe/ose ballafaqim me një gjendje të caktuar

4.3 Ndhimë këshilldhënëse për arsimimin e mëtejshëm të nxënësve

Temat:

- * Dhënie ndihmë gjatë zgjedhjes së profesionit/ institucionit për arsimim të mëtejshëm, për rikualifikim ose punësim¹³
- * Kujdes për fëmijët me vështirësi emocionale

Shumë mirë

- * Shkolla u siguron nxënësve informata të qarta, të sakta dhe më të reja për mundësitë e shkollimit të mëtejshëm, rikualifikim ose punësim. Për këtë qëllim organizon aktivitete dhe shfrytëzon material promovues të institucioneve arsimore (fletushka, tribuna, vizita nëpër shkolla dhe institucione të arsimit të lartë etj) për orientim profesional të nxënësve. Përgatitja që e organizon shkolla për nxënësit për zgjedhjen e arsimit të mëtejshëm, të rikualifikimit ose punësimit pas mbarimit të shkollës fillore dhe shkollës së mesme përmban një spektër të gjerë të qasjeve mirë të strukturuar: për shembull, vlerësim personal i shkathtësive dhe interesave të nxënësve, ndihmë në hartimin e biografisë së shkurtër, përgatitje për intervistë pune, informim i rregullt i prindërve dhe i nxënësve për ndihmën që mund ta marrin në shkollë, përmes njoftimeve të shkruara dhe gojore nga ana e shërbimeve profesionale. Shkolla u ofron nxënësve mundësi për organizimin e mirë të punës praktike. Shkolla ka bashkëpunim të rregullt me agjencinë për punësim dhe zbaton rregullisht testime për orientim profesional të nxënësve dhe i ndihmon për të zgjedhur drejtimin profesional.
- * Shkolla ka procedura të shkruara që të zbulojë me kohë dhe të kujdeset për nxënësit me probleme emocionale, pa dallim nga burimet e këtyre problemeve (për shembull, dhunë familjare, neglijencë familjare, divorci i prindërve, sëmundje në familje, trauma pas konflikteve). Shërbimi profesional është i trajnuar t'u ndihmojë nxënësve dhe/ose prindërve në këto situata ose t'i dërgojë në institucione relevante. Shkolla ka bashkëpunim të rregullt me institucionet relevante, siç janë: ambullanta, qendra për punë sociale, policia, etj.

Mjaftueshëm

- * Informatat për mundësitë e shkollimit të mëtejshëm, rikualifikimit dhe punësimit, që shkolla u siguron nxënësve, nuk janë gjithnjë të qarta, të sakta dhe relevante. Shkolla organizon aktivitete për orientim profesional të nxënësve vetëm me kërkesën e subjekteve të jashtme. Përgatitja që organizon shkolla për zgjedhjen e arsimit të mëtejshëm të nxënësve, për rikualifikim dhe punësim, pas shkollës fillore dhe të mesme është e kufizuar dhe jep vetëm informata të përgjithshme në kërkesë të prindërve dhe nxënësve. Shkolla organizon punë praktike për nxënësit, por ka cilësi të dobët dhe nuk u ofron nxënësve mundësi që të fitojnë shkathtësi praktike.
- * Shkolla posedon dispozita të shkruara për kujdesin e nxënësve me probleme emocionale. Për zbatimin e procedurave mban përgjegjësi shërbimi profesional.

Burimet e të dhënave:

Proçesverbale nga punëtoritë; Proçesverbale nga mbledhjet prindore; Anketa dhe intervista me nxënës dhe prindër; Informata të përgatitura nga shërbimi profesional dhe të plasura përmes medimeve ekzistuese të shkollës; Program për orientim profesional të nxënësve; Fletushka; Ligjërata; Proçesverbale nga biseda individuale me prindër dhe nxënës.

¹³ Ndhimë për arsimimin e mëtejshëm ofrohet edhe në shkollat fillore edhe në ato të mesmet, ndërsa për rikualifikim dhe/ose punësim jepet vetëm në shkollat e mesme.

4.4 Ndjekje e përparimit

Temat:

- * Mbatja e evidencës për përparimin individual të nxënësve
- * Analiza e përparimit të nxënësve sipas paraleleve

Shumë mirë

- * Mësimdhënësit¹⁴ mbajnë evidencë të rregullt dhe të plotë për arritjet, rregullshmërinë dhe sjelljen e secilit nxënës/nxënëse, si dhe për zhvillimin e tij/saj intelektual, social dhe emocional. Në evidencë veçanërisht janë të theksuara anët e mira të nxënësit/nxënëses dhe potencialet e tij/saj zhvilluese. Në evidencë përfshihen edhe të dhënat për përparimin e nxënësit/nxënëses, që janë fituar si rezultat i vlerësimit të bërë nga ana e mësimdhënësve në bashkëpunim me shërbimin profesional dhe prindërit e nxënësit/nxënëses. Ekziston bashkëpunim efektiv midis kuadrit udhëheqës, shërbimit profesional, mësimdhënësve lëndorë/kujdestarëve të klasës dhe prindërve për arritjet e nxënësve.
- * Mësimdhënësit përgatisin raporte dhe analiza të rregullta tremujore për paralelen e tyre, duke u mbështetur në evidencat individuale për nxënësit. Këto raporte dhe analiza të përgatitura për paralele të veçanta dorëzohen për mbikqyrje në shërbimin profesional dhe kuadrit udhëheqës dhe mund t'i shikojnë të gjithë mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit. Rezultatet nga këto analiza shfrytëzohen për përmirësimin e procesit edukativo-arsimor.

Mjaftueshëm

- * Mësimdhënësit mbajnë evidencë të rregullt për përparimin e arritjeve, rregullshmërisë, sjelljes të çdo nxënësi/nxënëseje. Në evidencë përfshihen edhe të dhëna për përparimin e nxënësit/nxënëses, të fituara në bazë të vlerësimit personal.
- * Mësimdhënësit përgatisin raporte tremujore për paralelen e vet, të cilat mund të lexohen nga të gjitha palët, sipas kërkesës së tyre. Rezultatet nga analizat nuk kanë pasqyrë dhe të dhënat e fituara shfrytëzohen rralë për përmirësimin e procesit edukativo-arsimor.

Burimet e të dhënave:

Raporte dhe analiza; Shqyrtim i evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik; Evidenca e nxënësve që kanë shkuar dhe nxënësve të ardhur. Bisedë me mësimdhënës dhe shërbimin profesional.

¹⁴ Në mësim klasor (klasa I-V) evidencën e mbajnë mësuesit, kurse në mësimin lëndor (prej klasës VI deri në VIII) dhe në shkollat e mesme, evidencën e mbajnë kujdestarët e klasave.

Rajoni 5. Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë

Nr.	Tregues për cilësi	Temat
5.1	Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë	<ul style="list-style-type: none"> • Prestigji/imazhi i shkollës • Kodi i sjelljes • Atmosfera e shkollës • Sjellja dhe disiplina në shkollë • Participimi i nxënësve në zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve
5.2	Promovimi i arritjeve	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i arritjeve personale të nxënësve • Promovimi i arritjeve në emër të shkollës
5.3	Barazi dhe drejtësi	<ul style="list-style-type: none"> • Njohja e të drejtave të fëmijëve • Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve • Pranimi dhe promovimi i multikulturalizmit
5.4	Marrëdhënie partnere me prindërit dhe me bashkësinë lokale dhe komunitetin afarist	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunim i shkollës me prindërit • Bashkëpunim me bashkësinë lokale • Bashkëpunim me komunitetin afarist dhe sektorin joqeveritar

5.1 Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë

Temat:

- * Prestigji/imazhi i shkollës
- * Kodi i sjelljes
- * Atmosfera e shkollës
- * Sjellja dhe disiplina në shkollë
- * Partecipimi i nxënësve në zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve

Shumë mire

- * Shkolla njihet sipas cilësisë së lartë të punës dhe sipas arritjeve të nxënësve në lëmi të ndryshme, si dhe sipas realizimit të vizionit dhe misionit të shkollës. Shkolla kujdeset për shëndetin dhe për sigurinë e nxënësve, kultivon sensibilitetin gjinor dhe multikulturën, e mbështet ekskluzivitetin dhe përforcon participimin e nxënësve, prindërve dhe bashkësisë në jetën shkollore. Kuadri mësimdhënës gëzon respect tek prindërit. Nxënësit dhe të punësuarit identifikohen me shkollën, kujdesen për prestigjin e saj dhe janë krenarë që janë pjesë e saj.
- * Shkolla posedon Kod të sjelljes me të cilin janë përcaktuar parimet dhe dispozitat e sjelljes të të gjitha strukturave në shkollë (kuadri udhëheqës, mësimdhënësit, shërbimi profesional, personeli teknik, nxënësit dhe prindërit). Në hartimin e tij kanë marrë pjesë përfaqësues të të gjitha strukturave, ndërsa gjatë miratimit të tij është zbatuar procedurë demokratike me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të gjitha strukturave. Shkolla posedon dispozita të shkuara për reagimin në qoftë se shkilen parimet dhe dispozitat e sjelljes, të parapara me kodin dhe procedurat e tilla i zbaton në praktikë.
- * Shkolla mban politikën e respektit reciprok dhe të trajtimit të barabartë të të gjitha strukturave që marrin pjesë në jletën shkollore. Në shkollë ekziston bashkëpunim profesional midis të punësuarve. Kuadri udhëheqës dhe arsimor luajnë rol të rëndësishëm për mbajtjen e atmosferës së përhershme të mirë në shkollë, që shihet nga sjellja e tyre me nxënësit, me të punësuarit e tjerë, prindërit dhe vizitorët e shkollës. Të punësuarit i udhëzojnë nxënësit të kujdesen për shkollën dhe për njëri tjetrin. Pothuajse të gjithë nxënësit (pa dallim nga aftësia, gjinia, përkatësia etnike, fetare dhe nga prejardhja) ndjehen të mirëpritur nga të rriturit dhe nga nxënësit e tjerë në shkollë.
- * Disiplina e nxënësve është shumë e mirë. Ekziston atmosferë pune gjatë mësimin dhe gjatë aktiviteteve të lira, ndërsa të punësuarit përherë kujdesen për sjelljen dhe sigurinë e nxënësve gjatë kohës së pushimeve, gjatë pritjes së nxënësve dhe largimit të tyre nga shkolla. Nxënësit janë të vetëdijshëm dhe bashkëpunojnë me kuadrin dhe mes veti dhe sillen me edukatë. Të punësuarit, me kujdes dhe me autoritet ballafaqohen me problemet, të cilat kanë të bëjnë me disiplinën dhe rregullshmërinë, dhe nuk ka ndërprerje të mësimin. Shkolla e zbaton rregulloren e masave pedagogjike në mënyrë adekuate.
- * Nxënësit informohen me kohë dhe tërësisht për të gjitha punët që janë në interesin e tyre të drejtpërdrejtë dhe marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve lidhur me ato punë.

Mjaftueshëm

- * Shkolla dallohet sipas arritjeve të nxënësve, më së paku në një lëndë ose një aktivitet të lirë. Të punësuarit me punën dhe sjelljen e vet nuk kontribuojnë për afirmimin e plotë të shkollës. Pjesa më e madhe e të punësuarve nuk e njofin mjaftueshëm misionin dhe vizionin e shkollës. Shkolla angazhohet për rritjen e kujdesit për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve, për kultivimin e sensibilitetit gjinor dhe për multikulturën, si dhe për mbështetjen e forcimit inkuadrimit e nxënësve, prindërve dhe bashkësisë në jetën shkollore. Një pjesë e vogël e kuadrit arsimor gëzon respect nga prindërit dhe një pjesë e vogël e nxënësve dhe të punësuarve identifikohen me shkollën.
- * Shkolla posedon Kodin e sjelljes me të cilin janë përcaktuar parimet dhe rregullat e sjelljes të të gjitha strukturave në shkollë (kuadrit arsimor, mësimdhënësve, shërbimit profesional, personelit teknik, nxënësve dhe prindërve). Në hartimin e këtij kodi nuk kanë marrë pjesë të gjitha strukturat, ndërsa miratimin e tij e ka bërë Këshilli i shkollës. Shkolla ka dispozita të shkuara për të reaguar në raste të thyerjes së parimeve dhe rregullave të sjelljes të parashikuara me kodin, por procedurat e tilla nuk zbatohen në praktikë në mënyrë konsekuente.
- * Në shkollë ekziston bashkëpunimi midis të punësuarve, nxënësve dhe të tjerëve të involvuar në procesin edukativo-arsimor, por ka fakte për marrëdhënie të prishura midis individëve. Kuadri udhëheqës dhe arsimor nuk janë konsekuentë në përpjekjet e tyre që të krijojnë atmosferë në shkollë. Ka raste kur sjellja e tyre me nxënësit dhe me të punësuarit e tjerë, me prindërit dhe vizitorët në shkollë e pengon zhvillimin e atmosferës positive në shkollë. Nuk i kushtohet kujdes i veçantë bashkëpunimit reciprok dhe kujdesit të nxënësve midis veti. Ka raste kur disa nxënës nuk janë të mirëpritur nga të rriturit dhe ose nga nxënësit në shkollë.
- * Disiplina e nxënësve kryesisht është e kënaqshme. Nxënësit kanë problem në bashkëpunimin me të punësuarit dhe nuk kujdesen për sjelljen e tyre. Të punësuarit disa herë ballafaqohen me sukses me problemet të cilat kanë të bëjnë me disiplinën dhe rregullshmërinë. Problemet me disiplinën dhe rregullshmërinë disa herë rezultojnë me masa pedagogjike të cilat disa herë mund të shmangen në qoftë se identifikohen me kohë dhe zgjidhen në bashkëpunim me të punësuarit, shërbimin profesional dhe prindërit. Shkolla e zbaton rregulloren për marrjen e masave pedagogjike.
- * Nxënësit kontribuojnë shumë pak në zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve për punët që janë në interes të drejtpërdrejtë të tyre. Nxënësit janë pjesërisht të informuar për punët e shkollës që janë në interes të tyre të drejtpërdrejtë.

Burimet e të dhënave:

Kodi i sjelljes; Anketa/intervista me mësimdhënës, prindër dhe nxënës; Evidenca pedagogjike për masat e shqiptuara pedagogjike; Rregullore për notim, përparim, dhënia e provimeve, lloje të lëvdatave, çmime dhe masa pedagogjike për nxënësit; Statuti i shkollës; Udhëzim për mënyrën e shqiptimit të masave pedagogjike në shkollat e mesme publike; Rregulli shtëpiak i shkollës; Lëvdata, çmime, mirënjohje etj.

5.2 Promovimi i arritjeve

Temat:

- * Promovime të arritjeve personale të nxënësve
- * Promovime të arritjeve në emër të shkollës

Shumë mirë

Shkolla vë theks të veçantë në arritjet e të gjithë nxënësve. Kuadri arsimor e organizon në mënyrë të suksesshme ambientin mësimor, me vendosjen e pritjeve të qarta dhe të larta në raport me arritjet, rregullshmërinë dhe disiplinën e nxënësve. Nxënësit gjithashtu presin shumë nga vetvetja dhe nga të tjerët; kanë aspirata për suksese më të larta në nivel të shkollës dhe në vlerësimet shtetërore. Kuadri arsimor, në mënyrë të suksesshme i shfrytëzon lëvdatat si mënyrë për motivim të mëtejshëm. Shkolla ka ndërtuar sistem të vlerave dhe mënyrë të promovimit të vlerave personale të të gjithë nxënësve në suazat e shkollës dhe në mjedisin më të gjerë lokal. Nxënësit kanë mundësi (sipas aftësive dhe interesave të tyre) ta shprehin të gjithë potencialin kreativ në mësim dhe në aktivitete të lira.

- * Shkolla zhvillon politikë të nxitjes së kuadrit arsimor dhe të nxënësve që të marrin pjesë dhe të arrijnë sukses nëpër garat lokale dhe në ato rajonale dhe shtetërore. Shkolla ka një sistem të zhvilluar të shpërblimit të nxënësve që kanë arritur sukses dhe për mësimdhënësit të cilët kanë ndihmuar në këtë gjë në të gjitha lëmitë, përmes të cilave e promovojnë shkollën.

Mjaftueshëm

- * Shkolla nuk ndërmerr aktivitete që të promovojë arritjet e nxënësve. Përkundër asaj që vlerësohen arritjet e larta të nxënësve në disa lëndë, kjo gjë nuk ndodh me të gjitha aktivitetet përmes të cilave mund të afirmohen nxënësit. Ambienti mësimor nuk i motivon nxënësit që t'i vënë vetes qëllim për arritje më të larta dhe pritja nga vetvetja është modeste. Kuadri arsimor nuk e sheh thelbin e lëvdatave si mënyrë për motivimin e nxënësve dhe ka raste kur këto shfrytëzohen në mënyrë joadekuate. Shkolla i promovon arritjet personale të të gjithë nxënësve vetëm në kuadër të shkollës.
- * Shkolla ka politikë të nxitjes së kuadrit arsimor dhe të nxënësve që të marrin pjesë dhe të arrijnë sukses në garat lokale, rajonale dhe shtetërore por nuk ka system të zhvilluar për shpërblime të nxënësve që kanë arritur sukses dhe për mësimdhënësit që kanë ndihmuar në të.

Burimet e të dhënave:

Program vjetor i punës së shkollës; Punime të ekspozuara të nxënësve; Pllakate me lëvdata, shpërblime; Promovimi medial i arritjeve të nxënësve; Intervista me mësimdhënëse dhe bashkëpunëtorë profesionalë, nxënës dhe prindër.

5.3 Barazi dhe drejtësi

Temat:

- * Njohja e të drejtave të fëmijëve
- * Trajtimi i drejtë dhe i barabartë i të gjithë nxënësve
- * Pranimi dhe promovimi i multikulturës

Shumë mirë

- * Të gjithë të punësuarit në shkollë i dinë dhe i respektojnë të drejtat e fëmijëve. Shkolla i nxit nxënësit që t'i mbrojnë të drejtat e veta edhe në raste kur ato shkenen. Shkolla organizon punëtori me prindërit, për t'i njohtuar ata me të drejtat e fëmijëve.
- * Të gjithë të punësuarit në shkollë në mënyrë të barabartë sillen ndaj të gjithë nxënësve, pa dallim nga gjinia, përkatësia etnike, sociale dhe aftësitë edhe kur bëhet fjalë për aktivitete në orë dhe jashtë orëve. Shkolla i promovon barazinë dhe drejtësinë si vlera themelore në të gjitha dokumentet e shkruara dhe ka mekanizma të zhvilluara, me të cilat zbaton respektimin e tyre në raport me të gjitha strukturat që marrin pjesë në jetën e shkollës (të punësuarit, nxënësit, prindërit). Nxënësit mësohen si t'i njohin dhe si të ballafaqohen me situatat konkrete që kanë të bëjnë me diskriminimin në kontekstin shkollor.
- * Shkolla zhvillon politikë për vlerësimin dhe promovimin pozitiv të llojllojshmërisë etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore në shkollë dhe në bashkësi. Nxënësit mësojnë të respektojnë kulturën e vet dhe kulturën dhe traditat e bashkësive të tjera etnike në Republikën e Maqedonisë, pa dallim nga grupi i vet etnik dhe pa dallim nga gjuha në të cilën e ndjekin mësimin. Shkolla organizon aktivitete të përbashkëta mësimore dhe/ose aktivitete të lira, të dedikuara për grupe të përziera kulturore/gjuhësore¹⁵ dhe i shfrytëzon të gjitha mundësitë strategjike që të sigurojë bashkëpunim ndëretnik të nxënësve dhe të punësuarve të të njëjtës shkollë ose me ndonjë shkollë tjetër.

Mjaftueshëm

- * Të punësuarit në shkollë janë të njohtuar me të drejtat e fëmijëve dhe mund të identifikojnë raste të shkeljes së tyre në praktikë. Shkolla i informon nxënësit për të drejtat e tyre, por nuk ju mundëson gjithnjë ta praktikojnë atë. Shkolla nuk ndërmerr aktivitete që t'i njohtojë prindërit me të drejtat e fëmijëve.
- * Shkolla i promovon barazinë dhe drejtësinë si vlera themelore në të gjitha dokumentet e veta të shkruara por nuk ka zhvilluar mekanizma, me të cilat siguron respektimin e tyre në raport midis të gjitha strukturave që marrin pjesë në jetën shkollore (të punësuarit, nxënësit, prindërit). Nxënësit mësohen se si t'i identifikojnë çështjet dhe se si të ballafaqohen me problemet që kanë të bëjnë me disiplinën në nivel global.
- * Shkolla shumë pak e vlerëson dhe e promovon llojllojshmërinë etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore në shkollë dhe bashkësi. Nxënësit mësojnë ta respektojnë kulturën dhe traditën e vet dhe atë të bashkësive të tjera etnike në Republikën e Maqedonisë, pa dallim cilit grup etnik i takojnë apo pa dallim nga ajo se në cilën gjuhë e ndjekin mësimin. Shkolla nuk organizon aktivitete mësimore dhe/ose aktivitete të lira, dedikuar për grupe të përziera kulturore dhe gjuhësore.

Burimet e të dhënave:

Evidencë dhe dokumentacion pedagogjik, në raport me përfshirjen e nxënësve në aktivitete të lira; Struktura e paraleleve; Intervista me nxënës; prindër dhe shërbim profesional; Pyetësor për nxënës dhe prindër; Ditar për punën e shërbimit profesional.

¹⁵ Shkolla ku mësimi zhvillohet në disa gjuhë e bën atë me grupe të përziera gjuhësore, kurse në shkollat ku mësimi ndiqet në një gjuhë e bëjnë atë me grupe të përziera kulturore (etnike). Shkollat me përbërje kryesisht njëetnike, bashkëpunojnë midis veti që të sigurojnë bashkëpunim multikulturor midis nxënësve.

5.4 Raport partneriteti me prindërit dhe me bashkësinë lokale dhe afariste

Temat:

- * Bashkëpunim i shkollës me prindërit
- * Bashkëpunim me bashkësinë lokale
- * Bashkëpunim me bashkësinë afariste¹⁶ dhe sektorin joqeveritar

Shumë mirë

- * Shkolla ndërmerr aktivitete të shumta të planifikuara mirë dhe organizon trajnime që t'i nxisë prindërit të inkuadrohen në punën edukativo-arsimore të shkollës në të gjitha nivelet. Prindërit nxiten që të marrin pjesë aktive në procesin mësimor përmes organizimit të ligjëratave në një temë konkrete ose me vizita në vendin e punës të prindit, si dhe në aktivitete të lira. Shkolla shfrytëzon metoda efektive për komunikim me prindërit, përmes organizimit të takimeve individuale prindore dhe ditëve të hapura për pritje, duke iu përshtatur kohës së lirë të prindërve. Informatat që kanë të bëjnë me të gjitha aspektet e punës të shkollës, siç janë qëllimet, organizimi, aktivitetet e ardhshme dhe niveli i arritjes së nxënësve janë të qarta, të organizuara mirë dhe janë të kapshme për prindërit. Prindërit janë të mirëpritur në shkollë.
- * Shkolla është inkuadruar në mënyrë aktive në jetën e bashkësisë lokale përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta dhe përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në ngjarje me interes për bashkësinë. Shkolla promovon inkuadrimin vullnetar të nxënësve në aktivitetet e bashkësisë. Bashkësia angazhohet për përmirësimin e kushteve të punës në shkollë. Shkolla promovon dhe pranon ndihmën vullnetare të bashkësisë në aktivitetet mësimore dhe të lira.
- * Shkolla realizon punë cilësore me bashkësinë afariste, përmes mësimi praktik të organizuar mirë dhe përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta të inicuar nga të dyja palët. Ekzistojnë shumë shembuj konkret për bashkëpunim të suksesshëm me sektorin joqeveritar dhe pjesëmarrja aktive e të punësuarve në projekte me interes të bashkësisë.

Mjaftueshëm

- Shkolla e pranon mbështetjen e prindërve, të cilët me iniciativën e vet dëshirojnë të marrin pjesë në jetën dhe punën e shkollës, por nuk ndërmerr aktivitete që t'i përfshijë të gjithë prindërit. Ndërkaq, shkolla nxit prindërit të përfshihen në punën e shkollës vetëm në suazat e niveleve formale të vendimit (Këshillin e prindërve, mbledhjet prindore dhe Këshillit shkollor). Komunikimi i shkollës me prindërit zbret në mbajtjen e dy mbledhjeve prindore në një gjysmëvjetor, por ka raste kur mbahen mbledhje individuale prindore. Informatat që kanë të bëjnë me punën e shkollës janë të shkurtëra dhe të paqarta për prindërit. Ka prindër, të cilët mendojnë se nuk janë të mirëpritur nga një pjesë e të punësuarve në shkollë.
- * Shkolla realizon bashkëpunim me bashkësinë lokale vetëm në suazat e obligimeve ligjore formale dhe ka shumë pak raste kur bëjnë projekte dhe ngjarje të përbashkëta.
 - * Shkolla bashkëpunon me bashkësinë afariste për realizimin e mësimi praktik. Shumë të rralla janë rastet për bashkëpunimin e realizuar me sektorin joqeveritar.

Burimet e të dhënave:

Raport për punën e shkollës (gjysmëvjetor, vjetor); Proçesverbale të Këshillit të prindërve dhe mbledhjeve prindore; Anketa dhe intervista me drejtorin, mësimdhënësit dhe shërbimin profesional; Dokumentacion dhe evidencë pedagogjike (për punën e dobishme shoqërore, për veprimtari kulturore publike); Statut i shkollës; Qasje në veb faqen e shkollës; Marrëveshje me bashkësinë afariste; Projekte të shkollës në funksion të zhvillimit të shkathtësive praktike të nxënësve; Proçesverbale dhe vendime nga mbledhjet e Këshillit shkollor; Ekzistimi i kompanive virtual dhe reale të nxënësve; Plan për kontakte dhe letërkëmbim i organizuar me bashkësinë afariste; Tribuna, ligjërata dhe debate të organizuara me prindërit dhe përfaqësuesit e bashkësisë afariste; Dokumentacion për donacionet dhe sponsorimet e fitura.

¹⁶ organizata ekonomike, punëtori artizanati, oda dhe bashkësi ekonomike

Rajoni 6. Resurse

Nr.	Tregues për cilësi	Tema
6.1	Akomodimi dhe kapacitetet hapsinore	<ul style="list-style-type: none"> • Kushtet hapsinore • Shfrytëzimi i kapaciteteve hapsinore
6.2	Mjetet dhe materialet mësimore	<ul style="list-style-type: none"> • Pajisja me literaturë profesionale dhe me mjete ndihmëse mësimore • Biblioteka e shkollës • Material shpenzues
6.3	Sigurimi i kuadrit të nevojshëm mësimor	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i të punësuarve dhe kuadri mësimor adekuat • Efektiviteti dhe vendosja e kuadrit • Shërbimi profesional si mbështetje e kuadrit mësimor
6.4	Ndjekja e nevojave zhvillimore të kuadrit mësimor	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi profesional i mësimdhënësve
6.5	Puna financiare në shkollë	<ul style="list-style-type: none"> • Procedurat me të cilat sigurohet respektimi i rregullativës ligjore për punën financiare • Transparenca në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit të shkollës

6.1 Akomodimi dhe kapacitetet hapsinore

Temat:

- * Kushtet hapsinore
- * Shfrytëzimi i kapaciteteve hapsinore

Shumë mirë

- * Hapësira shkollore¹⁷ i plotëson kushtet për mbajtjen e mësimit sipas Rregullores. Ekzistojnë kushte adekuate të këndshme për zhvillimin e mësimit, për punën e kuadrit arsimor dhe për organizimin e aktiviteteve të lira me nxënësit. Madhësia e klasës përshtatet me numrin e nxënësve nëpër paralelet.
- * Shkolla ka orar dhe plan të qartë dhe i shfrytëzon maksimalisht kapacitetet disponuese për zhvillimin e mësimit dhe të aktiviteteve të lira, me çka i plotëson nevojat e nxënësve.

Mjaftueshëm

- * Në shkollë ka hapësira të cilat nuk janë të përshtatshme për mësim sipas rregullores. Shkolla nuk ndërmerr aktivitete për përmirësimin e gjendjes ekzistuese. Është e nevojshme përshtatja e kushteve hapsinore për të siguruar kushte të këndshme për zhvillimin e mësimit, për punën e kuadrit arsimor dhe për organizimin e aktiviteteve të lira. Krahas numrit të madh të klasave që janë adekuate me numrin e nxënësve nëpër paralele, ndjehet mungesa e hapësirave për mbajtjen e mësimit praktik dhe të aktiviteteve të lira.
- * Shkolla nuk ndërmerr masa për shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve ekzistuese për zhvillimin e mësimit dhe të aktiviteteve të lira dhe si rezultat i kësaj, mësimdhënësit shfrytëzojnë një numër të vogël të kapaciteteve hapsinore.

Burimet e të dhënave:

Program vjetor të punës; Plan i zhvillimit të shkollës; Mbikqyrje e drejtpërdrejtë; Proçesverbale nga inspekcioni arsimor dhe sanitar; Orari i mësimit; Raport i gjysmëvjetorit dhe i fundvitit; Proçesverbale nga puna e grupeve profesionale; Intervista me mësimdhënësit.

¹⁷ Duke përfshirë edhe sallën e edukatës fizike dhe oborrin shkollor

6.2 Materiale dhe mjete mësimore

Temat:

- * Pajisje me literaturë profesionale, mjete mësimore dhe ndihmëse
- * Biblioteka shkollore
- * Materiali shpenzues

Shumë mirë

- * Shkolla disponon me literaturë të llojllojshme profesionale dhe mjete mësimore dhe ndihmëse në pajtim me Rregulloren për të gjitha lëndët mësimore. Shkolla i përcakton nevojat për mjete mësimore dhe ndihmëse, duke përfshirë aty librat, materialet për punë praktike, pajimet audio-vizuele dhe Teknologjive të informimit dhe komunikimit dhe në mënyrë të vazhdueshme ripërtrin ato që të jenë në përputhje me rrjedhat bashkëkohore mësimore. Mësimdhënësit dhe nxënësit dinë se cilat mjete mësimore dhe materiale të tjera kanë në disponim dhe të njejtat i shfrytëzojnë në mënyrë efektive dhe efikase në mësimdhënie dhe në mësim. Mësimi dhe mësimdhënia janë të pasuruara përmes shfrytëzimit të planifikuar të Teknologjive të informimit dhe komunikimit. Mësimdhënësit dhe nxënësit kanë qasje në internet.
- * Biblioteka shkollore disponon me më shumë se pesë tituj librash për një nxënës, duke përfshirë këtu edhe lekturat. Shkolla gjithashtu mban evidencën e rregullt të bibliotekës. Biblioteka është renditur bukur dhe disponon me kompjuter dhe qasje në internet. Biblioteka është e hapur për nxënësit gjatë tërë ditës shkollore.
- * Shkolla planifikon dhe siguron me kohë material shpenzues në sasi të mjaftueshme, për realizimin e aktiviteteve mësimore dhe aktiviteteve të lira sipas planit të shkollës.

Mjaftueshëm

- * Shkolla disponon me literaturë profesionale dhe mjete mësimore të cilat pjesërisht përputhen me rrjedhat bashkëkohore mësimore. Mësimdhënësit dhe nxënësit disa herë kanë qasje të kufizuar ndaj mjeteve mësimore dhe materialeve të tjera të nevojshme për mësim dhe mësimdhënie. Shkolla i përcakton nevojat për mjete mësimore dhe mjete ndihmëse, por nuk ka sistem për ndjekjen e përdorimit të tyre, për mirëmbajtjen dhe për blerjen e mjeteve të reja. Mësimdhënësit dhe nxënësit kanë qasje të kufizuar në internet.
- * Biblioteka shkollore disponon me 2 deri në 5 tituj të librave për një nxënës, duke përfshirë këtu lekturat dhe nuk mban evidencë të rregullt të bibliotekës. Orari i punës i bibliotekës nuk mundëson që nxënësit ta shfrytëzojnë atë gjatë tërë ditës shkollore.
- * Shkolla planifikon pajisjen e materialeve themelore shpenzuese, por kjo pajisje nuk i plotëson nevojat reale të shkollës.

Burimet e të dhënave:

Mbikqyrje e drejtpërdrejtë në dokumentacionin e shkollës për furnizimin e literaturës profesionale dhe mjeteve mësimore; Bisedë me mësimdhënësin, me shërbimin profesional dhe me drejtorin; Mbikqyrje në evidencën e bibliotekës; Bisedë me personin përgjegjës; Bisedë me nxënësit; Bisedë me mësimdhënësit; Anketë me nxënësit, bisedë me personelin teknik, mbikqyrje në dokumentacionin për materiale të planifikuara dhe të furnizuara shpenzuese; Evaluimi personal i nxënësve dhe plani zhvillimor i shkollës; Bisedë me mësimdhënësit dhe mbikqyrje e drejtpërdrejtë në dokumentacionin e shkollës dhe aktet interne; Mbikqyrje në aktet interne, raport për gjysmëvjetorin dhe për fundin e vitit, program vjetor, bisedë me mësimdhënësit; Proçesverbale nga grupet profesionale

6.3 Sigurimi i kuadrit të nevojshëm mësimit

Temat:

- * Numri i të punësuarve dhe kuadri adekuat arsimor
- * Efektiviteti dhe vendosja e kuadrit
- * Shërbimi profesional si mbështetje e kuadrit arsimor

Shumë mirë

- * Shkolla ka siguruar numër të mjaftueshëm të mësimitdhënësve, për realizimin e procesit edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe kuadrin e trajnuar për punë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore. Kuadri arsimor është në pajtim me normativat. Kuadri arsimor është i kualifikuar dhe i aftësuar për të ndërmarrë përgjegjësinë në procesin e mësimitdhënies, sipas nevojës së nxënësve dhe shkollës në tërësi. Puna e kuadrit arsimor është e plotësuar dhe e lehtësuar në mënyrë adekuate nga personeli administrativ dhe teknik.
- * Mësimitdhënësit në mënyrë efektive kontribuojnë për punën e shkollës dhe punojnë suksesshëm si ekipë, në suazat e grupeve profesionale. Gjatë vendosjes së kuadrit, merren parasysh cilësitë, përvoja dhe ekspertiza e mësimitdhënësve që kontribuon për plotësimin e qëllimeve të mësimit. Kur kjo zgjidhet në mënyrë adekuate, shkolla angazhon mësimitdhënës të specializuar ose ekspertë në lëminë përkatëse, të cilët punojnë në mënyrë efektive me kuadrin arsimor të shkollës. Në rastet kur kuadri arsimor mungon shkurtë ose më gjatë, shkolla ka mekanizëm për zëvendësimin e shpejtë dhe adekuat.
- * Shkolla ka shërbim profesional i cili u ndihmon mësimitdhënësve në organizimin e mësimit, në ndjekjen e përparimit të nxënësve, në ballafaqimin me problemet individuale dhe grupore dhe në dhënien e ndihmës adekuate nxënësve. Shërbimi profesional në programin e vet për punë planifikon dhe zbaton aktivitete të llojllojshme për punë me nxënës dhe arsimtarë dhe gjithnjë është i hapur për bashkëpunim.

Mjaftueshëm

- * Shkolla ka siguruar numër të mjaftueshëm të kuadrit arsimor për zbatimin e procesit edukativo-arsimor. Puna e kuadrit arsimor është e plotësuar dhe e lehtësuar nga personeli administrativ dhe teknik, mirëpo disa aspekte të punës duhet të përmirësohen. Kuadri arsimor posedon një varg kualifikime, shkathhtësi dhe përvoja të arritura përmes trajnimeve, por për disa nevoja të nxënësve dhe shkollës në tërësi mungon kuadri adekuat. Mësimitdhënësit kanë njohuri për proceset e mësimit dhe zhvillimit të fëmijëve, por jo edhe për nevojat e ndryshme specifike të tyre.
- * Cilësia e punës dhe kontributi i mësimitdhënësve për punën e shkollës nuk janë të përhershëm, kurse mësimitdhënësit gjithnjë punojnë si ekipë në suazat e aktivave të shkollës. Vendosja e kuadrit nuk bëhet gjithnjë sipas cilësisë, përvojës dhe ekspertizës së nxënësve, me çka zvogëlohet mundësia për plotësimin e qëllimeve të mësimit. Gjatë mungesës së kuadrit arsimor nuk mbahet llogari që të bëhet zëvendësimi me kohë dhe adekuat.
- * Shërbimi profesional i shkollës u ndihmon mësimitdhënësve në organizimin e mësimit, në ndjekjen e përparimit të nxënësve, në ballafaqimin me problemet individuale dhe grupore të tyre dhe/ose në dhënien e ndihmës këshilldhënëse të nxënësve pa ndonjë program të veçantë pune.

Burimet e të dhënave:

Qasje në dosjet e të punësuarve; Qasje në rregulloren e sistematizimit; Bisedë me drejtorin dhe mësimitdhënësit; Program vjetor për punën në shkollë; Program për punën e shërbimit profesional.

6.4 Ndjekja e nevojave zhvillimore të kuadrove mësimore

Tema:

- * Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Shumë mirë

- * Shkolla i identifikon nevojat e mësimitdhënësve për zhvillim profesional, posedon program dhe strategji për sigurimin e zhvillimit profesional (përfshirë këtu edhe mentorimin) dhe siguron përkrahje financiare në bazë të nevojave të identifikuara. Shkolla ka strategji për shpërndarjen e njohurisë së kuadrit. Shkolla e respekton rregullativën ligjore për zhvillimin profesional të kuadrit, ndërkaq ka edhe mekanizma të brendshëm për dhënien e mirënjohjeve kuadrit që fut inovacione efektive në punë. Kuadri arsimor ka dosje të azhurnuara të zhvillimit profesional.

Mjaftueshëm

- * Shkolla i identifikon nevojat e mësimitdhënësve për zhvillim profesional, në mënyrë jo sistematike. Shkolla herë herë siguron mbështetjen për zhvillim profesional të mësimitdhënësve, por kryesisht me kërkesën individuale. Shkolla nuk ka plan për shpërndarjen e njohurive të kuadrit. Shkolla e respekton rregullativën ligjore për zhvillim profesional të kuadrit.

Burimet e të dhënave:

Akte interne; Bisedë me shërbimin profesional, me mësimitdhënësit dhe drejtorin; Program për zhvillim profesional të kuadrit arsimor; Program për punë i mentorit dhe i të punësuarit të ri gjatë vitit shkollor; Anketa të shkollës për zhvillimin profesional të kuadrit; Listë për trajnime interne të zbatuara.

6.5 Puna financiare e shkollës

Temat:

- * Procedurat me të cilat sigurohet respektimi i rregullativës ligjore për punën financiare
- * Transparencë në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit shkollor

Mirë

- * Procedurat për punën financiare që i zbaton shkolla janë në përputhje me normativat ligjore. Kuadri udhëheqës ka mirëkuptim për mekanizmat që mund t'i përdorë për arritjen e mjeteve plotësuese financiare. Këshilli i shkollës është i njoftuar me aktivitetet financiare të shkollës. Kuadri udhëheqës e ndjek me vigjilencë shpenzimin e buxhetit, me qëllim që të fitojë cilësi adekuate për mjetet e shpenzuara financiare.
- * Shkolla i informon organet dhe trupat e shkollës për buxhetin shkollor dhe për shpenzimet. Personat përgjegjës rregullisht diskutojnë për informatat lidhur me resurset dhe përmes vendimeve që i sjellin sigurojnë ekonomi, efikasitet dhe drejtësi në shpërndarjen e mjeteve financiare. Kuadri udhëheqës konsultohet me të gjithë të punësuarit kur është nevoja dhe në nivel adekuat deri në detaje. Përparësitë buxhetore janë të lidhura ngushtë dhe pasqyrojnë prioritetet dhe qëllimet arsimore të shkollës. Buxheti shfrytëzohet me dedikim dhe për qëllime kreative, të cilat janë të fokusuara për përmirësimin e cilësisë së mësimit dhe mësimdhënies si dhe zhvillimit të shkollës në përgjithësi.

Mjaftueshëm

- * Procedurat për punën financiare që i zbaton shkolla janë në përputhje me normat ligjore. Kuadri udhëheqës ka pak mirëkuptim për mekanizmat që mund t'i shfrytëzojë për arritjen e mjeteve plotësuese financiare. Këshilli i shkollës është i njoftuar për aktivitetet financiare të shkollës. Kuadri udhëheqës nuk i ndjek shpenzimet e dedikuara të buxhetit me paragjykim se fiton cilësi adekuate për mjetet e shpenzuara financiare.
- * Shkolla i informon organet dhe trupat e shkollës për shpenzimin dhe buxhetin shkollor. Kuadri udhëheqës nuk konsultohet me një pjesë të personave përgjegjës për çështjet e lidhura me resurset, informata të cilat janë të rëndësishme për të siguruar ekonomi, efikasitet dhe drejtësi në shpërndarjen e mjeteve financiare. Përparësitë buxhetore nuk janë gjithmonë të lidhura dhe nuk e pasqyrojnë përparësinë dhe qëllimet arsimore të shkollës. Buxheti shfrytëzohet për qëllime afatshkurta ose përparësi të cilat nuk janë të lidhura me përmirësimin e cilësisë së mësimit dhe mësimdhënies si dhe me zhvillimin e përgjithshëm të shkollës.

Burimet e të dhënave:

Qasje në planin financiar, planin zhvillimor dhe programin vjetor të punës; Bisedë me drejtorin/ mësimdhënësit dhe Këshillin e shkollës; Proçesverbale dhe vendime të këshillit shkollor; Bisedë me Këshillin e prindërve; Marrëveshje të lidhura, tender për furnizime publike; Oferta; Proçesverbale nga revizioni i Drejtoria e të ardhurave publike.

Rajoni 7. Udhëheqja, menaxhimi dhe krijimi i politikës

Nr.	Tregues për cilësi	Temat
7.1	Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollës	<ul style="list-style-type: none">• Udhëheqja e shkollës• Menaxhimi i shkollës
7.2	Qëllimet dhe krijimi i politikës së shkollës	<ul style="list-style-type: none">• Qëllime të qarta dhe adekuate• Procedura për krijimin e politikës shkollore
7.3	Planifikimi zhvillimor	<ul style="list-style-type: none">• Qëllimet e planifikimit zhvillimor• Zhvillimi profesional dhe trajnim profesional i kuadrit• Mjetet materiale dhe teknike• Infrastruktura

7.1 Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollës

Temat:

- * Udhëheqja e shkollës
- * Menaxhimi i shkollës

Shumë mirë

- * Këshilli shkollor është konstituar në pajtim me rregulloren ligjore dhe Statutin e shkollës. Kompetencat për menaxhim janë qartë të definuara me Rregulloren e punës së Këshillit shkollor. Mbledhjet mbahen me shumicën e anëtarëve të këshillit. Këshilli shkollor u siguron informata të hollësishme dhe të gjithanshme për punën e vet, të gjitha subjekteve të kyçura në procesin edukativo-arsimor. Këshilli shkollor ka vendosur marrëdhënie partneriteti me organin udhëheqës të shkollës dhe me strukturat tjera arsimore.
- * Organi udhëheqës ka përcaktim strategjik, të mbështetur në vizionin e qartë që i përmban pikëpamjet dhe nevojat e të gjitha palëve të përfshira në jetën shkollore. Organi udhëheqës ka njohuri se në çfarë mënyre objektivist t'i vlerësojë cilësitë e të punësuarve dhe kontributin e tyre në punën ekipore dhe si ta promovojë praktikën e mirë që ekziston në shkollë. Sjell vendime përgjegjëse. Ka ndërtuar kredibilitet personal dhe marrëdhënie profesionale ndaj punës që mbështetet në shkathtësitë dhe dituritë më të reja, duke përfshirë dhe aftësinë efektive që të delegojë, të komunikojë dhe të udhëheqë me të punësuarit dhe zhvillimin e tyre. Merr iniciativa dhe menaxhon suksesshëm me ndryshimet në sistemin arsimor. Identifikon dhe fokusohet në prioritetet të qarta që janë identifikuar në planin zhvillimor përmes evaluimit personal efektiv, kurse në qendër të punës së vet i vendos arritjet e nxënësve dhe përmirësimin e pasqyrës shkollore. Vendos partneritete produktive në bashkësinë e drejtpërdrejtë dhe më të gjerë. Organi udhëheqës e mbështet punën e vet në punën e ekipore përmes përfshirjes së të punësuarve në procesin zhvillimor të politikave, të planifikimit dhe të sigurimit të cilësisë.

Mjaftueshëm

- * Këshilli shkollor është konstituar në përputhje me rregullativën dhe Statutin e shkollës. Këshilli shkollor ka rregullore për punë. Ka raste të anulimit ose të mosmbajtjes së mbledhjeve të Këshillit shkollor për shkak të mungesës së shumicës absolute për punë. Këshilli shkollor bashkëpunon me organin udhëheqës të shkollës dhe me struktura tjera arsimore vetëm në nivel formal.
- * Organi udhëheqës ka ide të përgjithshme për atë se çka është më së miri për shkollën, por nuk është fokusuar mjaftueshëm që të bëhet përcaktim strategjik i shkollës. I shmanget sjelljes së vendimeve me përgjegjësi. Ka marrëdhënie profesionale ndaj punës, që mbështetet në dituri relevante, edhe pse jo gjithnjë i zbaton suksesshëm në praktikë. Ballafaqohet me vështirësi gjatë udhëheqjes së ndryshimeve në sistemin arsimor dhe në inkurajimin e punëtorëve që t'i pranojnë të njejtat. Nuk është në gjendje që efektivist të delegojë, të komunikojë dhe të udhëheqë me të punësuarit dhe zhvillimin e tyre. Prioritetet e identifikuar në planin zhvillimor, nuk janë gjithmonë adekuate për përmirësimin e pasqyrës së shkollës dhe arritjet e nxënësve. Ka tendencë të udhëheqë me shkollën në izolim nga bashkësia e drejtpërdrejtë dhe më e gjerë. Jo gjithnjë punën e vet e mbështet në punën ekipore dhe vepron në mënyrë mbrojtëse ndaj çdo lloj komenti dhe kritike. Ekzistojnë shembuj të rrallë për punë ekipore dhe përfshirjen e të punësuarve në procesin zhvillimor të politikave, të planifikimit dhe të sigurimit të cilësisë.

Burimet:

Rregullore e punës të Këshillit shkollor; Statuti i shkollës; Proçesverbale, vendime dhe raporte nga puna e Këshillit shkollor (vjetore, gjysmëvjetore dhe të veçanta); Evaluim personal dhe plan zhvillimor i shkollës; Program për punën e drejtorit; Program për zhvillimin profesional të drejtorit; Intervista me mësimmdhënësit, prindërit dhe nxënësit; Intervistë me Këshillin shkollor.

7.2 Qëllime dhe krijim i politikës shkollë

Temat:

- * Qëllimet e qarta dhe adekuate
- * Procedurat për krijimin e politikës së shkollës

Shumë mirë

- * Qëllimet e shkollës janë në përputhje me qëllimet e politikës arsimore lokale dhe shtetërore. Qëllimet janë të qarta dhe precize dhe janë të fokusuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe arritjes maksimale të të gjithë nxënësve. Të punësuarit, prindërit dhe nxënësit marrin pjesë aktive në krijimin e qëllimeve, parimeve dhe vlerave të shkollës dhe janë të njohtuar me mënyrën e realizimit dhe përmirësimit të tyre. Shkolla i mobilizon të gjithë subjektet relevante (kuadrin, mësimdhënësit, nxënësit, bashkësinë lokale) që të punojnë për realizimin e qëllimeve. Arritja e qëllimeve ka ndikim pozitiv në punën e shkollës.
- * Të punësuarit marrin pjesë aktive në krijimin dhe azhurnimin e strategjive për realizimin e qëllimeve. Shkolla i merr parasysh edhe mendimet e prindërve dhe nxënësve.

Mjaftueshëm

- * Qëllimet e shkollës janë në përputhje me qëllimet e politikës arsimore lokale dhe shtetërore, por nuk iu jepet përparësi adekuate. Qëllimet kanë fokus të kufizuar ndaj sigurimit të cilësisë në mësim. Kuadri, prindërit dhe nxënësit janë të njohtuar me qëllimet, me parimet dhe me vlerat e shkollës si dhe me mënyrën e realizimit dhe vlerësimit të tyre, por nuk janë të përfshirë në realizimin e tyre. Nuk është e qartë se si kontribuojnë qëllimet e caktuara për përmirësimin e arritjeve të nxënësve.
- * Krijimi dhe azhurnimi i akteve bëhet në suaza të organeve dhe trupave të shkollës. Nuk janë të qarta strategjitë e realizimit të qëllimeve.

Burimet e të dhënave:

Program vjetor për punën e shkollës; Evaluim personal; Plan zhvillimor i shkollës; Plane akcionare; Anketa/ Intervista me drejtorin, shërbimin profesional, mësimdhënësit, prindërit, nxënësit; Proçesverbale nga Këshilli shkollor/Këshilli prindor/Këshilli arsimor; Akte interne

7.3 Planifikimi zhvillimor

Temat:

- * Qëllimet e planifikimit zhvillimor
- * Zhvillimi profesional/trajnimi profesional i kuadrit
- * Mjetet materiale dhe teknike
- * Infrastruktura

Shumë mirë

- * Qëllimet janë precize, të qarta dhe e reflektojnë misionin, vizionin dhe vlerat e shkollës. Gjatë përcaktimit të qëllimeve inkuadruhen mësimdhënësit, prindërit, nxënësit dhe përfaqësuesit e bashkësisë lokale. Shkolla ka plane aksionare për qëllimet e përcaktuara të cilat i zbaton në mënyrë konsekuente dhe ka plan për ndjekjen dhe vlerësimin e realizimit të aktiviteteve dhe arritjet e treguesve të caktuar për sukses. Shkolla i informon mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit lidhur me qëllimet e caktuara, dinamikën e realizimit të tyre dhe rezultatet e arritura. Shkolla i merr parasysh qëndrimet e mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe bashkësisë lokale.
- * Shkolla vazhdimisht i identifikon nevojat për trajnim profesional të kuadrit. Ka përgatitur program dhe ka siguruar mjete financiare në pajtim me nevojat e trajnimit profesional të të gjithë të punësuarve dhe avancimit të procesit edukativo-arsimor, duke përfshirë trajnimin për punë me nxënës që kanë nevoja të veçanta arsimore. Shkolla ka sistem për shpërndarjen e njohurive të nxëna dhe në mënyrë kontinuitive e ndjek zbatimin e njohurisë së arritur nga rikualifikimi.
- * Shkolla i identifikon me kohë nevojat për mjete materiale dhe teknike dhe vazhdimisht i planifikon dhe i siguron ato. Mjetet ekzistuese të konkretizimit janë në funksion dhe shfrytëzohen në mënyrë optimale. Shkolla planifikon dhe siguron mjete për mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre.
- * Shkolla vazhdimisht shqyrton planin për përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës së shkollës dhe siguron mjete të veta dhe mjete të donatorëve për investime të dedikuara. Shkolla ka bashkëpunim me vetqeverisjen lokale dhe bashkësinë lokale për të përmirësuar infrastrukturën.

Mjaftueshëm

- * Qëllimet pjesërisht pasqyrojnë misionin, vizionin dhe vlerat e shkollës. Shkolla ka plane aksionare për një pjesë të synimeve të caktuara. Rëndësia e tyre është e ndarë pjesërisht me mësimdhënësit, nxënësit dhe prindët, kurse shkolla angazhohet t'i marrë parasysh qëndrimet e mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve.
- * Shkolla herë herë i identifikon nevojat për zhvillimin profesional të kuadrit. Ka përgatitur program për zhvillimn profesional të të punësuarve, duke përfshirë edhe trajnime për punë me nxënës që kanë nevoja të veçanta arsimore, por me qasje selektive në realizimin e saj.
- * Shkolla nuk i planifikon dhe nuk i siguron në mënyrë sistematike mjetet materiale dhe teknike. Një pjesë e mjeteve të mbikqyrura nuk janë funksionale, kurse shkolla nuk ka planifikuar mjete për adaptimin e tyre dhe vënien në funksion.
- * Shkolla intervenon sipas nevojës dhe siguron mjete për përmirësimin e infrastrukturës së shkollës.

Burimet e të dhënave:

Evaluum personal dhe plan zhvillimor shkollor; Plane aksionare për arritjen e qëllimeve të përcaktuara; Plan i ndjekjes dhe evaluimit të realizimit të Planeve aksionare; Proçesverbale nga organet dhe trupat shkollore; Intervista me drejtorin, mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit; Program vjetor i punës; Plan për zhvillimin profesional; Raporte nga evaluimi intern; Inventar; Plan financiar i shkollës; Qasje në pajisjen; Qasje në infrastrukturë; Aplikacione të shkollës për sigurimin e mjeteve nga vetqeverisja lokale, bashkësia lokale, donatorë, etj.

Përshkrim i kriterëve

Kriteri:

- * Numri shumë i madh
- * Numri më i madh
- * Numër i vogël
- * Qasje/procedurë e caktuar

- * Qasje/procedurë e dakorduar

Përshkrimi:

- * Mbi 80% nga numri i përgjithshëm
- * Mbi 60% nga numri i përgjithshëm
- * Nën 30% nga numri i përgjithshëm
- * Dokument i shkruar, i cili është miratuar nga organet e shkollës
- * Qasje/procedura e miratuar gojarisht në seancat e organeve dhe trupave të shkollës